Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

# STRATEGJIA PËR TRANSPARENCË TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

## (2019-2021)



# STRATEGJIA PËR TRANSPARENCË TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (2019-2021)



**Përkthimi:** ESP - Zhvillim dhe Menaxhim me Burime Njerëzore SHPK
**Redaktimi gjuhësor:** ABAKUS

**Ekipi i Ekspertëve për përgatitjen e Strategjisë për Transparencë të Qeverisë së RMV-së me Plan Aksional (2019-2021)**

Dr. Ana Pavllovska Daneva, Eksperte vendase

Veronika Kretu, Eksperte ndërkombëtare

Dançe Danillovska-Bajdevska, Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni

Qëndresa Sulejmani, Fondacioni Metamorfozis

**Grupin i punës për përgatitjen e Strategjisë për Transparencë të Qeverisë së RMV-së me Plan Aksional (2019-2021)**

Aleksandar Pisarev, Platforma e organizatave të shoqërisë civile për luftë kundër korrupsionit
Bardhyl Jashari, Fondacioni Metamorfozis
Vlladimir Dellov, Ministria e Drejtësisë
German Filkov, Qendra për Komunikime Qytetare
Dançe Danillovska-Bajdevska, Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni
Darko Duridanski, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe e Punëtorëve të Medias
Edip Bilall, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)
Zhorzh Popovski, Komisioni për Mbrojtjen e Të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik
Ivana Bilbilovska, Ministria e Financave
Ilija Zhupanoski, Kabineti i Kryeministrit të Qeverisë së RMV-së
Ilina Mangova, Instituti Ndërkombëtar Republikan
Konstantin Bitrakov, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë
Lidija Cvetanoviq, Kabineti i ministrit Robert Popovski
Marija Tegovska, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
Milla Josifovska, Fondacioni Metamorfozis
Neda Maleska Saçmaroska, Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve
Nuri Bajrami, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
Oliver Serafimovski, Komisioni për Mbrojtjen e Të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik
Svetllana Siljanovska, Kabineti i Kryeministrit të Qeverisë së RMV-së
Simona Kruntovska, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së
Qëndresa Sulejmani, Fondacioni Metamorfozis

ActionSEE

МЕТАМОРФОЗИС

FOUNDATION OPEN SOCIETY MACEDONIA
ФОНДАЦИЈА ОТВОРЕНО ОПШТЕСТВО МАКЕДОНИЈА

Projekti është bashkë-financuar nga

Projekti është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtjet e këtij publikimi janë përgjegjësi e vetme e partnerëve të projektit "ACTION SEE – Accountability, Technology and Institutional Openness Network in SEE" dhe në asnjë mënyrë nuk i shprehin qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Ky publikim u përgatit me mbështetjen e Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni. Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e grantmarrësit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit.

# Përmbajtja

Pjesa 1: Shënime të përgjithshme lidhur me Strategjinë për transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2019-2021) .......... 2

**1. HYRJE** .......... 3

1.1. Arsyet e miratimit të Strategjisë .......... 3

1.2. Karakteristikat themelore të Strategjisë .......... 4

1.2.1 Përfshirja e Strategjisë .......... 5

**2. VIZIONI, MISIONI, QËLLIMET, NOCIONET DHE PARIMET THEMELORE TË STRATEGJISË PËR TRANSPARENCË TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (2019-2021)** .......... 6

2.1. Vizioni dhe misioni i Strategjisë .......... 6

2.2. Nocionet dhe parimet themelore të Strategjis .......... 9

**3. MONITORIMI DHE RAPORTIMI** .......... 11

Përcaktime strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2019-2021 .......... 12

**3. QASJA TEK INFORMACIONET ME KARAKTER PUBLIK** .......... 13

3.1. Gjendja aktuale .......... 13

3.1.1. Sfidat .......... 14

3.1.2. Udhëzime strategjike .......... 16

**4. TRANSPARENCA AKTIVE E QEVERISË DHE E ORGANEVE TË TJERA TË PUSHTETIT EKZEKUTIV** .......... 17

4.1. Gjendja aktuale .......... 17

4.1.1. Sfidat .......... 20

4.1.2. Udhëzime strategjike .......... 24

5. PËRGATITJA E AKTEVE NËNLIGJORE ... 27
5.1. Gjendja aktuale ... 27
5.1.1. Sfidat ... 27
5.1.2. Udhëzime strategjike ... 28
6. HARMONIZIMI ME DIREKTIVËN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR PËRDORIMIN E SËRISHËM TË INFORMACIONEVE ME KARAKTER PUBLIK ... 28
6.1. Gjendja aktuale ... 28
6.1.1. Sfidat ... 28
6.1.2. Udhëzime strategjike ... 29

Pjesa 3: Anekse të Strategjisë për transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriu ... 29

Aneksi 1: Pasqyra e një pjese të organeve që janë përfshirë me Strategjinë për transparencë të QRMV-së ... 30
Aneksi 2: Plan-veprimi i Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021) ... 34

## Pjesa 1:

## Shënime të përgjithshme lidhur me Strategjinë për transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2019-2021)

# 1. HYRJE

## 1.1. Arsyet e miratimit të Strategjisë

Realizimi efektiv i të drejtave dhe lirive të qytetarëve nëpërmjet rritjes së përgjegjësisë së institucioneve është një nga impenjimet kryesore të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut (në tekstin në vijim: QRMV). Në këtë drejtim, QRMV-ja detektoi se një nga parakushtet kryesore në këtë drejtim është fuqizimi i transparencës së QRMV-së dhe i organeve, përkatësisht organizatave të cilat përgjigjen para saj. Përkatësisht, rritja e nivelit të transparencës ka impakt pozitiv mbi aspektin e demokratizimit të shtetit ndërkaq qytetarëve u mundëson të kenë kontroll mbi institucionet. Me fjalë të tjera, transparenca ndikon pozitivisht edhe mbi zhvillimin ekonomik të shtetit, por edhe mbi aspiratat euroatlantike të tij. Ajo është komplementare me reformën e administratës publike dhe me arritjen e orientimit shërbyes të organeve publike.

Viteve të fundit QRMV-ja bëri përpjekje të shumta për rritjen e transparencës së vet, përkatësisht transparencës së organeve të cilat përgjigjen para saj. Kjo, midis të tjerash, u apostrofua edhe nga Bashkimi Evropian. Përkatësisht në Raportin e Progresit për Republikën e Maqedonisë së Veriut, i vitit 2019 (në tekstin në vijim: Raporti 2019)[1] potencohet se "progres i [m]irë është arritur në fushën e zhvillimit të politikave dhe në koordinimin e tyre, veçanërisht me implementimin e kornizës strategjike për reformën e administratës publike, me konsultat e përmirësuara publike dhe me **transparencën e rritur në ndërtimin e politikave**".[2] Pastaj, Bashkimi Evropian nënvizon se "[Q]everia ndërmori masa që **ta përmirësojë** menaxhimin me financat publike dhe **transparencën",**[3] ndërsa përveç të tjerash u theksua edhe fakti se "[Q]everia vazhdoi ta konsolidojë demokracinë dhe sundimin e së drejtës [...] dhe ta **përmirësojë** procesin e vendimmarrjes dhe **transparencën në punën e saj**",[4] përkatësisht se "[p]rogres është shënuar në aspektin e **transparencës buxhetore,** nëpërmjet publikimit të buxhetit qytetar dhe rritjes së informacioneve buxhetore".[5] Si rrjedhim, është evident qëndrimi pozitiv i Bashkimit Evropian dhe janë të dukshme dallimet në krahasim me vitet e kaluara (Raport

1 Gjendet në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf (qasje më 06.09.2019).

2 Shih: faqen 4 të Raportit 2019.

3 Shih: faqen 5 të Raportit 2019.

4 Shih: faqen 9 të Raportit 2019.

5 Shih: faqen 12 të Raportit 2019.

Progresi për Republikën e Maqedonisë nga viti 2016), ku theksohet se "[Sh]teti posaçërisht duhet [...] ta sigurojë implementimin e plotë të parimeve të përgjegjësisë, transparencës dhe meritës", përkatësisht se "transparenca buxhetore nuk është siguruar sepse informacionet buxhetore dhe statistikore nuk publikohen, nuk janë të qarta, gjithëpërfshirëse, në kohë të duhur dhe relevante".[6]

Megjithatë, edhe krahas progresit të shënuar, QRMV-ja edhe më tutje e identifikon nevojën për përpjekje të konsoliduara, të koordinuara dhe plotësisht të fokusuara në drejtim të përmirësimit të transparencës së vet, si dhe të transparencës së organeve të cilat përgjigjen para saj.

Si rrjedhim, në mbledhjen e saj të rregullt nr. 126, QRMV-ja e shqyrtoi dhe miratoi informatën për nevojën e hartimit të **Strategjisë për transparencë të QRMV-së**. Kjo Strategji rezulton nga vizioni për besimin e ndërtuar të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj Qeverisë, përkatësisht ndaj ministrive dhe ndaj organeve të tjera të administratës shtetërore dhe institucioneve të pushtetit ekzekutiv dhe krijimit të ambientit transparent dhe të besueshëm në vigjilje të proceseve të integrimit në Bashkimin Evropian dhe NATO.

### 1.2. Karakteristikat themelore të Strategjisë

Strategjia është një dokument dyvjeçar për periudhën kohore dhjetor 2019 - dhjetor 2021, që ka të bëjë jo vetëm me transparencën pasive (e cila edhe për momentin është detyrim ligjor), por edhe me transparencën aktive (në literaturë e emërtuar edhe si "vullnetare"). Me fjalë të tjera, kjo Strategji duhet ta motivojë QRMV-në, ministritë, organet në përbërje të ministrive, organet e pavarura të administratës shtetërore, organet e pavarura shtetërore të cilat përgjigjen para QRMV, organizatat administrative, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore, themelues i të cilave është QRMV-ja: (1) ato vet t'u ofrojnë qytetarëve sa më shumë informacione, pa e shfrytëzuar të drejtën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik; (2) ta unifikojnë praktikën e tyre nga aspekti i shkëmbimit të informacioneve (unifikim të ueb-faqeve nga aspekti i llojit të të dhënave dhe dokumenteve që publikohen, unifikim të formatit në të cilin shkëmbehen të dhënat); (3) ta lehtësojnë të drejtën e qasjes tek informacionet me karakter publik, në përputhje me ligjin përkatës; (4) të ofrojnë qasje tek dokumentet e tyre, por edhe në mënyrë aktive t'i ndihmojnë qytetarët gjatë kërkimit të ndonjë dokumenti të caktuar. .

Në aspekt të raportit të kësaj Strategjie me dokumentet e tjera zhvillimore, do ta veçonim Strategjinë ekzistuese për të dhëna të hapura(2018-2020). Këto dy dokumente janë komplementare – si njëra ashtu edhe strategjia tjetër duhet të kontribuojnë (në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejt) për një transparencë më të madhe të organeve qendrore të pushtetit ekzekutiv. Nga njëra anë thelbi i Strategjisë për të dhëna të hapura (2018-2020) është parashikimi se në ç'mënyrë do të publikohen të dhënat (se të njëjtat do

6 Gjendet në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf (qasje më 06.09.2019), f. 10 dhe f. 11.

të jenë të lexueshme në kompjuter dhe të papërpunuara), ndërsa nga ana tjetër Strategjia për transparencë (2019-2021) shkon një hap më tutje dhe bën fjalë për atë se cilat të dhëna konkretisht do të publikohen, përkatësisht në ç'mënyrë do të ndihmohen qytetarët kur do të duan të kenë qasje te të dhënat. Ky dokument strategjik është komplementar edhe me Strategjinë për reformë të administratës publike (2018-2022),[7] ndërkaq i rëndësishëm është edhe Plani-veprimi nacional për partneritet të hapur qeveritar 2018-2020, në të cilin janë përmbledhur përpjekjet për lehtësimin e qasjes tek informacionet dhe për transparencë më të madhe – si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal.[8]

Në bazë të konkluzionit nga mbledhja e rregullt nr. 126-të e QRMV-së, Strategjia për transparencë të QRMV-së (2019-2021) u hartua nga Grupi i Punës i udhëhequr nga ministri Robert Popovski, i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë. Ai përbëhet nga përfaqësues të Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së, Komisionit për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik (i cili do të transformohet në Agjenci për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik (në tekstin në vijim i emërtuar si Agjenci ose ASPI), në përputhje me Ligjin për qasje deri tek informacionet me karakter publik i publikuar në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" nr. 101/2019), Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Zyrës së Presidentit të RMV-së, Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, si dhe përfaqësuesve të disa shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve – Fondacioni Metamorfozis, Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni, Qendra për Komunikime Qytetare, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik, Qendra për Menaxhimin me Ndryshime, Platforma e Organizatave Qytetare për Luftë Kundër Korrupsionit, Instituti Republikan Ndërkombëtar (IRI) dhe Instituti Demokratik Nacional (NDI). Në Draft-strategjinë rol thelbësor kishin padyshim edhe përfaqësuesit e komunitetit akademik. Përfshirja e subjekteve të lartpërmendura u imponua si një garanci e llojit të vet për cilësinë e Strategjisë.

Para se të fillojë hartimi i kësaj Strategjie, nga ana e Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV, u realizuan pyetësorë me ekspertë të komunitetit akademik, të praktikës juridike, sektorit joqeveritar dhe medias (gjithsej 7 pyetësor), por edhe me 35 nëpunës administrativë të cilët punojnë në fushën e marrëdhënieve me publikun ose të cilët janë të autorizuar të marrin vendime në lidhje me kërkesat për qasje tek informacionet me karakter publik. Përgjigjet e këtyre pyetësorëve shërbyen si indikatorë shtesë gjatë përcaktimit të konkluzioneve nga analiza desktop. Megjithatë, asnjë qëndrim nuk u bazua krejtësisht mbi të njëjtat, duke e pasur në konsideratë numrin e vogël të personave të anketuar.

Si pjesë përbërëse e Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021) është edhe Plan-veprimi për implementimin e saj.

7 Gjendet në: http://arhiva.mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-2022_20022018_mk.pdf (qasje datë 09.09.2019).

8 Gjendet në: http://www.mioa.gov.mk/?q=mk/documents/open-government-partnership (qasje më 21.10.2019)

### 1.2.1 Përfshirja e Strategjisë

Strategjia për Transparencë të QRMV-së (2019-2021) i përfshin: QRMV-në, ministritë, organet në përbërje të tyre, organet e pavarura të administratës shtetërore, organet e pavarura shtetërore të cilët përgjigjen para QRMV-së (personat udhëheqës të cilët i zgjedh/ emëron QRMV-ja) organizatat administrative të cilat përgjigjen para QRMV-së, si dhe ndërmarrjet publike të themeluara nga QRMV-ja dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore. Si rrjedhim, është jashtëzakonisht i rëndësishëm fakti se Strategjia për transparencë të QRMV-së (2019-2021) i përfshin jo vetëm ato organe të formuara me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2000, 44/2002, 82/2008, 167/2010 dhe 51/2011 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/2019 dhe 110/2019), por edhe organet e formuara me ligje të veçantë. Një pjesë e këtyre organeve janë prezantuar në ueb-faqen e QRMV-së.[9]

Si rrjedhim, QRMV-ja është themeluese e 26 prej 142 ndërmarrjeve shtetërore.[10] Secila prej tyre është përfshirë me këtë dokument strategjik.

Në Aneksin numër 1 është prezantuar një pjesë e këtyre organeve, organizatave, ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në pronësi shtetërore të cilat janë përfshirë me këtë Strategji. Lista e prezantuar në Aneksin numër 1 nuk është e absolvuar, përkatësisht shërben për ilustrim dhe për t'u kuptuar Strategjia më mirë nga palët e interesuara dhe nga qytetarët.

9 Gjendet në: https://vlada.mk/node/14061 (qasje më 06.09.2019).
10 Shih: http://www.ccc.org.mk/images/stories/partizacijamk1.pdf (qasje më 09.09.2019).

# 2. VIZIONI, MISIONI, QËLLIMET, NOCIONET DHE PARIMET THEMELORE TË STRATEGJISË PËR TRANSPARENCË TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (2019-2021)

## 2.1. Vizioni dhe misioni i Strategjisë

Strategjia për Transparencë të QRMV-së bashkë me Plan-veprimin rezulton nga **vizioni** si vijon**:**

**Vizioni i Strategjisë**

Besimi i ndërtuar i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj QRMV, përkatësisht ndaj ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore dhe institucioneve të pushtetit ekzekutiv dhe krijimit të ambientit transparent dhe të besueshëm.

Nga ana tjetër, **Misioni** i këtij dokumenti strategjik-planor, korrespondon me vizionin:

**Misioni i Strategjisë**

Realizimi i të drejtës së qytetarëve për të qenë plotësisht të informuar mbi punën e QRMV-së, e organeve dhe organizatave të cilat përgjigjen para saj, me ç'rast rritet besimi i tyre ndaj institucioneve të pushtetit ekzekutiv të cilat përgjigjen para saj.

Si rrjedhim, bëhet e qartë se nga aspekti i Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021) është esenciale ndërlidhja e dy nocioneve: (*) transparenca dhe (*) besimi. Përkatësisht, parashtrohet pyetja se si do të ndikojë transparenca e rritur mbi besimin e qytetarëve ndaj QRMV-së?

**Misioni i Strategjisë**

Në mënyrë që të shpjegohet ndikimi pozitiv që do të duhej ta ketë transparenca mbi besimin e qytetarëve ndaj QRMV-së, fillimisht duhet të përkufizohet ky nocion. Kështu që, në përcaktimin e elementëve të nocionit **transparencë**, QRMV i referohet literaturës teorike, burimeve ndërkombëtare të së drejtës, legjislacioneve, si dhe shembujve krahasues

të dokumenteve strategjike-zhvillimore.[11],[12],[13],[14] Përcaktimet e shumtë të nocionit kanë dy karakteristika të përbashkëta: së pari, transparenca me patjetër lidhet, gjithmonë me demokratizimin e shoqërisë dhe, së dyti, ajo ndërlidhet gjithmonë me të drejtën e qytetarëve të kërkojnë dhe të pranojnë informacione mbi punën e Qeverisë dhe administratës së tyre (kuptuar në aspektin më të gjerë të fjalës),[15] përkatësisht me obligimin e institucioneve dhe organeve korrespondente t'i dërgojnë dhe publikojnë ato të dhëna. Me fjalë të tjera, QRMV-ja, identifikon se pushteti/qeveria e caktuar politike, organi i caktuar i administratës shtetërore nuk mund të vlerësohet si transparent / transparente pa u përmbushur së paku këto dy parakushte: (*) qytetarët në mënyrë efektive ta realizojnë të drejtën e tyre të kërkojnë të dhëna me karakter publik, me ç'rast të mos ballafaqohen me vështirësi, dhe, (*) të evidentohet publikimi proaktiv i të dhënave publike.[16] Megjithatë, QRMV shkon një hap përpara në përcaktimin e elementëve të nocionit **transparencë**, kështu që dy parakushteve të theksuara ua shton edhe këto si vijojnë:

- Informacionet të cilat dërgohen ose publikohen të mund të përdoren me lehtësi;
- Qasja tek informacionet të mos identifikohet me qasjen tek dokumentet (qytetari mund ta ketë në dispozicion dokumentin, megjithatë arritja tek informacioni mund të

11 Më shumë për përkufizimin e nocionit transparencë: https://carnegieendowment.org /2014/10/20/accountability-transparency-participation-and-inclusion-new-development-consensus-pub-56968 (qasje më 06.09.2019).

12 Më shumë për përkufizimin e nocionit transparencë: Michener G., Bersch K. (2013). I dentifying transparency, Information Polity 18 (2018) 233-242. Gjendet në: https: //pdfs. semanticscholar.org/4ac7/ 5190784e6eec337d61ce86d45718a910bfaf.pdf (qasje më 06.09.2019).

13 Më shumë për përkufizimin e nocionit transparencë:: Bellver A., Kaufmann D. (2005). Transparenting Transparency: Initial Empirics and Policy Adaptations, World Bank Policy Research Working Paper, gjendet në: https://www.google.com /search?q=Transparenting+Transparency%3A+Initial&rlz=1C1GGRV_ enMK758MK758&oq=Transparenting+Transparency%3A+Initial&aqs=chrome.. 69i57.822j0j7&sourceid=chrome&ie=UTF-8 (qasje më 06.09.2019).

14 Raporti i rrethit të pestë të vlerësimit "Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit të pushtetit qendror (funksionet më të larta ekzekutive) dhe të organeve që e zbatojnë ligjin", i miratuar nga GREKO në Seancën Plenare nr. 82 (Strasburg, 18-22, mars, viti 2019), gjendet në: https://rm.coe. int/-/168095378e (qasje më 06.09.2019).

15 Danilovska-Bajdevska D., Petrovska M., Naumovska N. (red.). (2013). Tejkalimi i parimeve të fshehtësisë në punën e administratës – Raport nga hulumtimi i realizuar për të drejtën e qasjes së lirë tek informacionet me karakter publik në Maqedoni, Fondacioni Shoqëria e Haur Maqedoni, f. 9, gjendet në: http://fosm.mk/CMS/Files/Documents/istrazuvanje-tajnnost-vo-rabotenjeto-mkd-1. pdf (qasje më 06.09.2019).

16Cilat të dhëna do të publikohen në mënyrë proaktive varet nga shteti në shtet, por marrë në përgjithësi mund të shihet se në pjesën më të madhe të sistemeve demokratike ekziston pajtueshmëria me "10-Point Transparency Checklist" Illinois Policy Institute. Gjendet në: https:// www.illinoispolicy.org/10-point-transparency-checklist/ (qasje më 06.09.2019).

jetë sfidë serioze), përkatësisht qytetarëve t'u ofrohet ndihmë aktive gjatë kërkimit të të dhënës së caktuar;

- Qasja tek informacionet të mos ketë shpenzime;
- Qytetarëve t'u ofrohet ndihmë aktive në rastin kur kërkojnë qasje tek informacionet me karakter publik, në përputhje me parimin e ndihmës aktive të palës të inkorporuar në nenin 17 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2015);
- Të gjitha draftet e akteve normative dhe të akteve të tjera të përgjithshme juridike, por edhe të dokumenteve të tjerë të cilët në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë ndikojnë mbi qytetarët dhe mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, të cilat i miraton QRMV, ministritë, organet në përbërje të ministrive, organet e tjera të administratës shtetërore, organizatat administrative dhe organet shtetërore të cilat përgjigjen para QRMV, të publikohen dhe të gjenden lehtë;
- Qytetarët të kenë këqyrje në shpenzimin e mjeteve buxhetore, por edhe në të ardhurat buxhetore (shuma që grumbullohet nga qytetarët nëpërmjet donacioneve, taksave dhe detyrimeve të tjera).

Si rrjedhim, në kuadër të këtij dokumenti strategjik-zhvillimor, do të bëhet fjalë për **transparencën aktive**..

Sa i përket çështjes se në ç'mënyrë do të ndikojë transparenca mbi përforcimin e besimit të qytetarëve ndaj QRMV-së, organeve dhe organizatave të përfshira me Strategjinë, shpjegimi prezantohet në vijim..

Së pari, publikimi proaktiv i të dhënave do të ndikojë pozitivisht mbi perceptimin e qytetarëve, përkatësisht do të shërbejë si metodë që të vihet në dukje se QRMV-ja dhe organet e përfshira me këtë Strategji nuk i fshehin të dhënat për punën e tyre dhe për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve publike (buxhetore).

Së dyti, publikimi i të dhënave, si dhe i dokumenteve origjinale në format që është i lehtë për përdorim do ta nënkuptojë diferencimin ndërmjet transparencës, nga njëra anë, dhe marrëdhënieve me publikun, nga ana tjetër. QRMV-ja e mbështet fuqimisht qëndrimin se çdo qytetar dhe faktor në shoqëri do të mund të marrë jo vetëm njoftim të njëanshëm për aktivitetet e saj por, edhe të ketë këqyrje në dokumentet origjinale nga të cilat rezultojnë të dhënat.

Së treti, publikimi proaktiv i të dhënave dhe veçanërisht të propozim-akteve normative, do ta stimulojë pjesëmarrjen e qytetarëve (në mënyrë të drejtpërdrejt ose të përfaqësuar nëpërmjet shoqatave të qytetarëve dhe formave të tjera të asociimit) në ndërtimin e politikave, kështu do të rritet edhe besimi i qytetarëve në cilësinë e akteve normative dhe akteve të tjera.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lart, është evidente se duhet të përkufizohen edhe disa nocione që janë të rëndësishme për këtë Strategji, dhe pastaj do të prezantohen edhe parimet themelore të tyre.

### 2.2. Nocionet dhe parimet themelore të Strategjisë

Përveç transparencës, që u përcaktua në kapitullin paraprak, për këtë dokument strategjik janë të rëndësishme edhe disa nocione të cilat i prezantojmë në vijim:

- **Transparenca aktive:** E emërtuar edhe si vullnetare, transparenca aktive nënkupton publikimin e të dhënave nga ana e QRMV-së dhe organeve të administratës shtetërore, kështu që qytetarët, personat juridikë, mediat dhe të tjerë të mos i përdorin mekanizmat për qasje tek informacionet me karakter publik të inkorporuara në legjislacion (Ligji për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik i publikuar në "Gazetën Zyrtare të RMV" nr. 101/2019).[17]
- **Përgjegjësia:** Përgjegjësia lidhet ngushtë me transparencën. Nëse transparencën e përkufizojmë si publikim aktiv i të dhënave nga QRMV-ja dhe organet e administratës shtetërore, përgjegjësia e determinon lidhjen institucionale të më shumë faktorëve në mënyrë që të përcaktohet kur njëri prej tyre duhet të sanksionohet për ndonjë veprim të tij ose për mossuksesin në përmbushjen e qëllimeve të caktuara. Kur flitet për organet e administratës shtetërore, mund të bëhet fjalë për përgjegjësi horizontale dhe vertikale.18 Përgjegjësia horizontale i përfshin lidhjet institucionale midis organeve, kështu që disa organe i kontrollojnë të tjerat. Nga ana tjetër, lidhja vertikale i përfshin lidhjet midis qytetarëve dhe organeve të administratës shtetërore.
- Inkluzioni dhe pjesëmarrja: Në përgjithësi, këto nocione nënkuptojnë sigurim të kushteve për një përfshirje sa më të gjerë të qytetarëve të informuar, por edhe konsultimin e tyre në rastin kur duhet të merren vendime dhe miratohen politika (të kuptuara në aspektin më të gjerë të fjalës).19 Si rrjedhim, në kuptimin e kësaj Strategjie, pjesëmarrja do të ketë vetëm domethënie të tërthortë. Nuk do të parashikohen masa konkrete për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve gjatë miratimit të politikave dhe vendimeve (të kuptuara në aspektin më të gjerë të fjalës, dhe jo si akte konkrete administrative), por publikimi proaktiv i të dhënave nëpërmjet qasjes së unifikuar do të ketë ndikim pozitiv mbi këtë çështje. Me fjalë të tjera, aludohet në faktin se ka probabilitet më të madh që qytetarët të marrin pjesë në krijimin e politikave publike dhe vendimeve nëse posedojnë informacione në kohë të duhur në lidhje me proceset që zhvillohen në QRMV dhe në organet e tjera publike.

---

17Michener G., Bersch K. (2013). Identifying transparency, Information Polity 18 (2018) 233-242, I aksesshëm në: https://pdfs.semanticscholar.org/4ac7/5190784e6eec337d61ce86d45718a910bfaf.pdf (ueb-faqja është aksesuar për herë të fundit më datë 8.7.2019)

18Cerna L. (2014). Trust: What it is and Why it Matters for Governance and Education, OECD Education Working Papers, no. 108, OECD Publishing. Gjendet në: https://www.oecd-ilibrary.org/education/trust-what-it-is-and-why-it-matters-for-governance-and-education_5jxswcg0t6wl-en (qasja në ueb-faqe për herë të fundit ka qenë më 08.07.2019).

19 Më shumë në: https://www.undp.org/content/undp/en/home/2030-agenda-for-sustainable-development/peace/governance/inclusive-political-processes.html (qasja në ueb-faqe për herë të fundit ka qenë më 08.07.2019)

Strategjia për transparencë të QRMV-së (2019-2021) bazohet në disa parime themelore:

- **Gjithëpërfshirja:** Në kuptimin e këtij dokumenti strategjik, gjithëpërfshirja ka dy dimensione: së pari, ka të bëjë me QRMV-në, me të gjitha ministritë, me organet në përbërje të tyre, organet e pavarura të administratës shtetërore, me organet e pavarura shtetërore, me organizatat administrative të cilat mbajnë përgjegjësi para QRMV-së, me ndërmarrjet publike të themeluara nga QRMV-ja dhe me shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore; dhe së dyti, me të do të përfshihen të gjitha të dhënat me përjashtim të atyre të cilat në përputhje me ligjin nuk konsiderohen si të dhëna publike.
- **Unifikimi:** Në përputhje me atë që është thënë për nocionin e transparencës është e domosdoshme që të dhënat të publikohen në mënyrë të tillë e cila do të mundësojë përdorimin e tyre nga qytetarët, subjektet afariste, mediat dhe të tjerët. Si rrjedhim, do të përcaktohet në mënyrë të saktë formati ku duhet të publikohen këto të dhëna dhe t'i dërgohen publikut, përkatësisht se si saktësisht duhet të duken ueb-faqet e organeve të përfshira, në mënyrë që qytetarët të mos ballafaqohen me praktika të ndryshme.
- **Përdorimi i të dhënave**: QRMV-ja dhe organet publike do t'i publikojnë të dhënat në mënyrë dhe format që do t'u mundësojë qytetarëve, përkatësisht të gjitha subjekteve të interesuara, përdorim të lehtë.
- **Në kohë të duhur:** Në kohë të duhur është njëri nga parimet themelore të këtij dokumenti strategjik. Përkatësisht, ky parim bazohet në përcaktimin e vlerës se nuk mjafton vetëm publikimi i të dhënave, por i njëjti duhet të bëhet në kohë të duhur, në afat sa më të shkurtër pas krijimit të tyre, përkatësisht të pranohen në afat sa më të shkurtër nga organet.
- **Interneti si burim kryesor:** Në kohën e zhvillimit të vazhdueshëm të teknologjisë, duhet të merret si qëndrim i pranuar në përgjithësi se burimi kryesor i të dhënave dhe informacioneve duhet të jetë interneti. Pranimi i internetit si burim kryesor i informacioneve ndikon pozitivisht edhe në mbrojtjen e mjedisit jetësor.
- **Transparenca automatike:** Të dhënat që do të përfshihen me këtë Strategji me automatizëm do të konsiderohen si të dhëna transparente për publikun.
- **Publikimi i dokumenteve:** QRMV-ja dhe organet publike do të duhet t'i publikojnë jo vetëm të dhënat për punën e tyre (sipas listës paraprakisht të dakorduar – check list dhe në përputhje me parimin e përdorimit), por edhe dokumentet nga të cilat nxirren ato të dhëna. Në këtë mënyrë qytetarët nuk do ta kenë vetëm rolin e pranuesit të informacionit, por ata do të mund ta bëjnë vetë kontrollin e saktësisë së informacionit përkatës (për shembull, nëse në ueb-faqen e ministrisë përkatëse është ofruar e dhëna për neto-pagën e ministrit, duhet të jenë në dispozicion edhe dokumentet

sipas të cilave është përllogaritur kjo pagë).

- **Mosdiskriminimi:** Parimi i mosdiskriminimit nënkupton faktin se çdo person i interesuar do të mund të ketë qasje me lehtësi te të dhënat e përfshira me këtë Strategji. Asnjë subjekt nuk do të duhet të regjistrohet dhe identifikohet ose ta arsyetojë qasjen e vet te të dhënat. Përveç kësaj, nuk do të ketë kurrfarë kufizimesh sa i përket përdorimit të softuerit ose aplikacionit për qasje te informacionet ose dosarët me të dhëna. Nga ana tjetër, në përputhje me parimin e mosdiskriminimit, organet dhe organizatat e përfshira në këtë Strategji duhet të sigurojnë qasje deri te të dhënat edhe për personat e kategorive vulnerabile, si dhe për personat me aftësi të kufizuar. Si rrjedhim, në mënyrë të veçantë duhet të merret parasysh parimi i barazisë, i paanshmërisë dhe objektivitetit (nga neni 8), parimi i orientimit shërbyes të organeve publike (nga neni 9) dhe parimi i ndihmës aktive të palës (nga neni 17) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

# 3. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Në mënyrë që të sigurohet implementim sa më i suksesshëm i Strategjisë për transparencë të QRMV-së, do të formohet Grupi i Punës për Monitorimin e Implementimit të saj.

Grupi i Punës për Ponitorimin e Implementimit të Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021) do të ketë përbërje të gjerë, përkatësisht në përbërjen e tij do të ketë nga një përfaqësues prej:

- Kabinetit të ministrit pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë;
- Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së;
- ministrive;
- sektorit akademik (universitetet dhe institucionet e tjera shkencore);
- sektorit qytetar (shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet);
- mediave, dhe
- komunitetit të biznesit.

Grupi i Punës do të ketë 7 anëtarë dhe do të themelohet nga ministri i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë. Anëtarët e Grupit të Punës të cilët janë përfaqësues të sektorit akademik, mediave dhe komunitetit të biznesit do të nominohen në mënyrë përkatëse nga Konferenca interuniversitare, nga dhomat ekonomike dhe nga

shoqatat e gazetarëve. Përfaqësuesit e sektorit joqeveritar do të paraqiten në thirrjen e shpallur nga Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe sektorit qytetar.

Grupi i Punës vazhdimisht do ta monitorojë progresin lidhur me implementimin e Strategjisë për Transparencë të QRMV-së (2019-2021), përkatësisht do të monitorojë nëse masat dhe aktivitetet e parashikuara me Plan-veprimin janë ndërmarrë në afatet e parashikuara. Përveç kësaj, Grupi i Punës do të propozojë nisma për ndërgjegjësim dhe informim lidhur me transparencën aktive, si dhe do t'i mbështesë, përkatësisht do t'i këshillojë organet dhe organizatat e përfshira me Strategjinë për transparencë të QRMV-së në lidhje me atë se si t'i përmbushin më mirë obligimet e tyre. Grupi i Punës do të grumbullojë informacione në lidhje me implementimin e Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021), nëpërmjet takimeve dhe korrespondencës zyrtare për të pranuar raporte për realizimin e masave.

Krahas formimit të Grupit të Punës, si një lloj i mekanizmit të jashtëm, për implementimin më të suksesshëm të kësaj Strategjie parashikohet formimi i njësisë organizative për zhvillim strategjik dhe transparencë në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV[20], e cila do të ngarkohet për grumbullimin dhe analizën e të dhënave që kanë të bëjnë me implementimin e këtij dokumenti strategjik, përkatësisht me transparencën aktive. Kjo njësi organizative do të përpilojë raporte tremujore për implementimin e Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021), përkatësisht implementimin e Plan-veprimit, të cilat Sekretariati i Përgjithshëm do t'ia paraqesë ministrit pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë. Në tekstin në vijim janë prezantuar shumë të dhëna për themelimin dhe punën e kësaj njësie organizative. Përfundimisht, ministri pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë QRMV-së do t'i paraqesë raporte gjashtëmujore për implementimin e Strategjisë. Këto raporte do të shqyrtohen në mbledhjet e QRMV-së. Ministri pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë do t'i hartojë raportet e theksuara në bazë të raporteve tremujore të pranuara nga njësia organizative për zhvillim strategjik dhe transparencë në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së, si dhe në bazë të të dhënave të pranuara nga Grupi i Punës për Monitorimin e Implementimit të Strategjisë.

20 Organogrami gjendet në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/organogram_na_generalniot_sekretarijat.pdf (qasje më 08.09.2019).

## **Pjesa 2:**
## Përcaktime strategjike të Qeverisë së Republikës sëMaqedonisë së Veriut për periudhën 2019-2021

# 3. QASJA TEK INFORMACIONET ME KARAKTER PUBLIK

### 3.1. Gjendja aktuale

E drejta e qasjes së lirë tek informacionet me karakter publik është parashikuar në nenin 16, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ligji i parë për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik u miratua në vitin 2006 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2006, 86/2008, 6/2010, 42/2014, 148/2015, 55/2016 dhe 64/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/2019).

Në vitin 2019 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e miratoi ligjin e ri për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/2019). Ky ligj akoma nuk zbatohet për shkak të nenit 46 me të cilin parashikohet veprim i prolonguar prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi (30.05.2019) ose thënë me fjalë të tjera, deri më 30.11.2019. Propozues i ligjit të ri nga viti 2019 është QRMV-ja. Arsyeja kryesore për miratimin e këtij ligji të ri ishte zbatimi i pamjaftueshëm dhe i paplotë i ligjit ekzistues për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik i miratuar në vitin 2006, përkatësisht siç theksoi QRMV-ja në propozimin që e paraqiti në Kuvend "[edhe] pse në Ligjin për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik janë inkorporuar parimet themelore mbi të cilat bazohet e drejta për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, ekziston zbatim jo i plotë dhe jokonsekuent i Ligjit, transparencë e kufizuar të institucioneve dhe realizim jo i plotë i së drejtës së personave fizikë dhe juridikë për qasje tek informacionet me karakter publik". Në këtë kontekst, është evident angazhimi i QRMV-së për përmirësimin e regjimit për qasje tek informacionet. Në këtë mënyrë, jo vetëm që do të përmirësohet klima demokratike në shtet, por në mënyrë adekuate do t'u përgjigjet vërejtjeve të komunitetit ndërkombëtar, veçanërisht të GREKO-s. Përkatësisht, në Raportin nga rrethi i pestë i vlerësimit, GREKO përcaktoi se "ekipi për evalvim i GREKO-s është i vetëdijshëm për implementimin e tij [të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik] të dobët dhe joefektiv".[21] Midis këtyre dy ligjeve për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik, ekzistojnë disa dallime kryesore:

21Raporti nga rrethi i pestë i vlerësimit "Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit të pushtetit qendror (funksionet më të larta ekzekutive) dhe të organeve ligjzbatuese", i miratuar nga GREKO në Seancën plenare nr. 82 (Strasburg, 18-22 mars të vitit 2019), gjendet në: https://rm.coe.int/-/168095378e (qasje më 06.09.2019).

- U zgjerua lista e poseduesve të informacioneve;
- U shkurtuan afatet për qasje tek informacionet;
- Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik (në tekstin në vijim: KoQLI) transformohet në organ të pavarur - Agjenci;
- Parashikohet detyrim për publikimin proaktiv të dokumenteve dhe të dhënave në ueb-faqen e çdo organi.

Ligji për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik i vitit 2019 përmban edhe një sërë risish të tjera. Zbatimi efikas dhe konsekuent i dispozitave të tij është njëri nga prioritetet e QRMV-së, si një hap përpara drejt transparencës më të madhe, përkatësisht përgjegjësisë më të madhe të saj, por edhe të organeve dhe organizatave të tjera të përfshira me këtë Ligj.

### 3.1.1. Sfidat

Sipas analizës së gjendjeve, e cila u bë gjatë të përgatitjes së këtij dokumenti strategjik, ekzistojnë shumë sfida që kanë të bëjnë me qasjen tek informacionet me karakter publik.

Sfida e parë ka të bëjë me **parimin e delegimit të kompetencës për vendimmarrje në procedurat sipas kërkesave për qasje tek informacionet me karakter publik.** Ligji ekzistues (i vitit 2006) dhe ligji i ri (i vitit 2019) për qasje tek informacionet me karakter publik parashikojnë se çdo posedues i informacioneve duhet të përcaktojë një ose më shumë persona zyrtarë të cilët do të ndërmjetësojnë në realizimin e të drejtës për qasje të lirë tek informacionet. Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, veç tjerash, parashikon se kompetenca për zgjidhjen e çështjeve administrative në kuadër të organeve publike, sipas rregullit, u delegohet personave zyrtarë. Me fjalë të tjera, Ligji për procedurë të përgjithshme administrative identifikon se në organet publike për të drejtat, obligimet dhe interesat juridikë në procedurë administrative nuk duhet të vendosin funksionarët, por personat zyrtarë të punësuar në organ dhe të cilët i kryejnë në mënyrë profesionale detyrat e tyre. Në këtë mënyrë synohet profesionalizmi më i madh dhe reduktimi i mundësisë për shpërdorimin e pozitës zyrtare për vendimmarrje. Si rrjedhim, në rastet kur qytetarët do të paraqesin kërkesë për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, vendimin (nëse do të lejohet qasja ose jo) nuk duhet ta marrë funksionari (ministër, drejtor dhe e ngjashëm), por nëpunësi administrativ i cili është caktuar si person zyrtar i cili do të ndërmjetësojë gjatë realizimit të së drejtës për qasje të lirë tek informacionet. Megjithatë, analizat në terren vënë në dukje faktin se parimi i delegimit të kompetencës për vendimmarrje nuk respektohet akoma në nivel të mjaftueshëm në procedurat administrative, ndërsa rrjedhimisht me këtë as në procedurat për kërkesat për qasje tek informacionet me karakter publik. QRMV-ja një gjë të tillë e ka konstatuar që në mbledhjen e saj të rregullt nr. 120-të të mbajtur më datë 12 shkurt të vitit 2019, kur i ngarkoi organet e administratës shtetërore të cilët zhvillojnë procedura

administrative në mënyrë konsekuente ta respektojnë parimin e delegimit të kompetencës.[22] QRMV-ja është konsekuente në qëndrimin e vet për zbatimin e plotë të parimit të delegimit të kompetencës, duke i përfshirë edhe procedurat për qasje tek informacionet me karakter publik. Pritet që në të ardhmen funksionarët të mos e aprovojnë qasjen tek informacionet me karakter publik, madje as të nënshkruajnë aktvendime me të cilat pjesërisht ose plotësisht kufizohet qasja, sepse një gjë e tillë do t'u delegohet plotësisht personave zyrtarë për ndërmjetësim. Vetëm në këtë mënyrë do të mundësohet profesionalizëm i plotë gjatë procedurave ndërkohë që, nga ana tjetër, do të reduktohen edhe mundësitë e shpërdorimit të pozitës zyrtare për vendimmarrje, si dhe rreziqet nga gabimet.

Sfida e dytë **heshtja e shpeshtë e administratës kur paraqiten kërkesa për qasje tek informacionet**.

*Tabela 1 – Heshtja e administratës si shkas për paraqitjen e ankesës te KoQLI-ja në 10 vitet e fundit*[23]

| Viti | Ankesa te KoQLI-ja të paraqitura për shkak të heshtjes së administratës | Numri i përgjithshëm i ankesave |
|---|---|---|
| 2018 | 366 | 622 |
| 2017 | 569 | 758 |
| 2016 | 411 | 619 |
| 2015 | 874 | 960 |
| 2014 | 785 | 849 |
| 2013 | 428 | 564 |
| 2012 | 907 | 1.225 |
| 2011 | 324 | 409 |
| 2010 | 368 | 540 |
| 2009 | 273 | 340 |

TSfida e tretë ka të bëjë me **zbatimin e dispozitave të cilat e parashikojnë afatin e përgjigjes ndaj kërkesës për qasje tek informacionet.** Në këtë drejtim, tanimë u theksua se afati i përgjigjes ndaj kërkesës për qasje tek informacionet në të kaluarën ishte 10 ose 30 ditë (varësisht fakti nëse kërkesa është verbale ose me shkrim), ndërsa tani ky afat është 5 ose 20 ditë (varësisht fakti nëse kërkesa është parashtruar në mënyrë verbale ose me shkrim).

22Procesverbali nga mbledhja numër 120 e QRMV-së gjendet në: https://vlada.mk/sednica/120 (qasje më 09.09.2019).

23 Податоците се изведени од годишните извештаи на КоСПИ достапни на: http://komspi.mk/%d0%b3%d0%be%d0%b4%d0%b8%d1%88%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d0%b7%d0%b2%d0%b5%d1%88%d1%82%d0%b0%d0%b8/ (пристапено на 9.9.2019).

Megjithatë, këto afate nuk janë minimale, por maksimale. Ligji ekzistues dhe ligji i ri për qasje tek informacionet me karakter publik specifikojnë se përgjigjja ndaj kërkesës duhet të jepet menjëherë, ndërsa më së voni në afatet e përcaktuara. Përkundrejt kësaj, ekspertët dhe shoqatat e qytetarëve theksojnë vazhdimisht se poseduesit e informacioneve presin çdoherë që të skadojë afati maksimal para se ta lëshojnë informacionin,[24] pa marrë parasysh faktin se a nevojitet me të vërtetë një kohë kaq e gjatë që të arrihet tek informacioni, përkatësisht që të dërgohet ai. Praktika e këtillë i zmbraps jo vetëm qytetarët por edhe gazetarët që të paraqitin kërkesa për qasje tek informacionet.[25] Duhet të ndryshohet me patjetër praktika e poseduesve të informacioneve, veçanërisht të atyre të cilët mbajnë përgjegjësi para QRMV-së të cilët do të përfshihen me këtë dokument strategjik, kështu që ata do të fillojnë t'u përgjigjen kërkesave brenda afatit sa më të shpejtë të mundshëm.

Sfida e katër ka të bëjë me **formatin në të cilin paraqitet kërkesa për qasje tek informacionet**. Ligji ekzistues dhe ligji i ri për qasje të lirë tek informacionet parashikojnë mundësi që kërkesa të parashtrohet në formë verbale, të shkruar ose elektronike, megjithatë qytetarët më shpesh e kanë qasje vetëm te forma me shkrim.

Sfida e pestë ka të bëjë me **transparencën aktive të parashikuar në nenin 10, paragrafi 1 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik,** përkatësisht me **obligimin që çdo posedues i informacioneve në ueb-faqen e vet të publikojë më shumë dokumente dhe të dhëna.**

Është e paevitueshme të mos theksohet se njëra nga sfidat që paraqitet është edhe **njohja e pamjaftueshme e dispozitave të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik nga ana e poseduesve të informacioneve**. Në mënyrë të veçantë duhet të merret në konsideratë kompleksiteti i materies, përkatësisht fakti se një pjesë e mirë e obligimeve nga Ligji nënkuptojnë profesionalizëm serioz. Një shembull i këtillë është zbatimi i testit të dëmit.

### 3.1.2. Udhëzime strategjike

Në përputhje me kornizën e theksuar juridike, por edhe me sfidat e elaboruara, në vazhdim prezantohen disa udhëzime strategjike për përmirësimin e realizimit efektiv të së drejtës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik në prag të zbatimit të ligjit të ri. Ato e përfshijnë edhe transparencën aktive, përkatësisht detyrimin e poseduesve nga neni 10, paragrafi 1 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, i vitit 2019:

24Sipas hulumtimit të realizuar nga Qendra për Komunikime Qytetare në vitin 2017, numri mesatar i ditëve për pranimin e përgjigjes ndaj kërkesës për qasje tek informacionet me karakter publik ka qenë 20 ditë. Nga ana tjetër, 24% e ministrive janë vonuar me përgjigjet, 59% janë përgjigjur në afatin e parashikuar, ndërsa 17% nuk janë përgjigjur. Për më tepër shih: http://ccc.org.mk/images/stories/ia2017m.pdf (08.09.2019).

25 Bozhoviq S., Danilovska D. (2018). Raport preliminar për zbatimin e kornizës ligjore lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet me karakter publik, Fondacioni Metamorfozis, f. 16, gjendet në: http://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2018/04/1.5-Preliminaren-izveshtaj-sloboden-pristap.pdf (qasje më 09.09.2019).

- Implementimi i plotë i parimit të delegimit të kompetencës për vendimmarrje në procedurat për kërkesat për qasje tek informacionet me karakter publik, në përputhje me nenin 13 dhe nenin 24 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, përkatësisht në kontekstin e konkluzionit të theksuar nga mbledhja e rregullt e 120-të e QRMV-së.[26]
- Avancimi i praktikës së QRMV-së, ministrive, organeve në përbërje të ministrive, organeve të pavarura të administratës shtetërore, organizatave administrative dhe organeve të pavarura shtetërore të cilat mbajnë përgjegjësi para QRMV-së në procedurat për qasje tek informacionet me karakter publik, nëpërmjet përpilimit të udhëzuesve dhe materialeve të tjerë didaktikë për funksionarët dhe për personat zyrtarë, në të cilat do të trajtohet zbatimi konsekuent i parimit të delegimit, afatet, rrjedha dhe fazat e procedurës për qasje tek informacionet, mundësia e paraqitjes së kërkesës në formë verbale, të shkruar dhe elektronike dhe pasojat e veprimit të paligjshëm dhe të padrejtë.
- Vendosja e marrëdhënieve të partneritetit midis QRMV-së dhe Agjencisë, para së gjithash, me qëllim të shkëmbimit të rregullt të të dhënave për (mos)veprimin e organeve të cilët në përputhje me dispozitat ligjore, mbajnë përgjegjësi para QRMV-së, që funksionarët në fjalë të mund të thirren në përgjegjësi nga QRMV-ja (nuk përjashtohet mundësia e përgjegjësisë para Kuvendit), si dhe me realizimin e analizave për shkallën e zbatimit të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik.
- Vendosja e mekanizmave nëpërmjet të cilëve QRMV-ja do të ushtrojë kontroll nëse ministritë, organet në përbërje të ministrive, organet e pavarura të administratës shtetërore, organizatat administrative dhe organet e pavarura shtetërore të cilët përgjigjen para saj dërgojnë raporte vjetore tek Agjencia (aktualisht KoQLI).

Në Plan-veprimin, i cili është pjesë përbërëse e Strategjisë për transparencën e QRMV-së (2019-2021) janë parashikuar aktivitete konkrete për secilën prej këtyre udhëzimeve strategjike, si dhe indikatorët e monitorimit.

Sa i përket udhëzimit të fundit strategjik që është theksuar në këtë pikë të Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021), ai duhet të merret parasysh në korrelacion me përcaktimet e unifikimit të ueb-faqeve (i prezantuar në vijim).

26 Gjendet në: https://vlada.mk/sednica/120 (qasje më 09.09.2019).

# 4. TRANSPARENCA AKTIVE E QEVERISË DHE E ORGANEVE TË TJERA TË PUSHTETIT EKZEKUTIV

### 4.1. Gjendja aktuale

QRMV-ja në vitin 2011 u bë pjesë e "Partneritetit për Qeverisje të Hapur" („Open Government Partnership). Në këtë kontekst u miratua Plan-veprimi nacional për partneritet të hapur qeveritar 2018-202027, në të cilin – midis tjerash – bëhet fjalë edhe për përmirësimin e transparencës, si dhe për transparencën aktive.

Gjatë dy viteve të kaluara, QRMV-ja ndërmori një numër të madh përpjekjesh për përmirësimin e transparencës së saj aktive, përkatësisht për krijimin e praktikës për publikimin proaktiv të të dhënave. Ideja për publikimin e tillë proaktiv të të dhënave korrespondon me përfitimin e dyfishtë të qytetarëve dhe institucioneve. Qytetarët do të mund të marrin informacione për legjislacionin, aktet normative dhe aktet nënligjore të organeve, për të drejtat dhe detyrimet e tyre, përkatësisht informacione me të cilat do të mund t'i thërrasin funksionarët në përgjegjësi. Nga ana tjetër, institucionet do të jenë më të përgjegjshme gjatë përdorimit dhe shpenzimit të mjeteve publike dhe në këtë mënyrë do t'i promovojnë parimet e qeverisjes së mirë dhe të integritetit. QRMV-ja, në kuadër të kompetencës së vet, nëpërmjet disa aktiviteteve u përpoq ta fuqizojë transparencën aktive të ministrive, organeve në përbërje të ministrive dhe të gjitha organeve të tjera shtetërore dhe administrative, përkatësisht të organizatave administrative të cilat mbajnë përgjegjësi para saj. Megjithatë, QRMV-ja identifikoi se transparenca e saj aktive (përkatësisht transparenca aktive e organeve të cilat mbajnë përgjegjësi para saj) edhe më tutje është sfida kryesore. Me fjalë të tjera, hulumtimet e realizuara nga organizatat qytetare e vënë në dukje faktin se pushteti ekzekutiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitet e kaluara ka qenë më pak transparent në krahasim me vendet e rajonit të Evropës Juglindore, përkatësisht e pasqyruar në përqindje 36%.[28] Nga ana tjetër, duke diskutuar për QRMV-në, transparenca është vlerësuar me 52%. Edhe pse pjesa më e madhe e rekomandimeve të organizatave qytetare[29]

27Gjendet në: http://www.mio.gov.mk/?q=mk/documents/open-government-partnership (qasje më 08.09.2019).
28 Shih: Metamorphosis. (2017). Roadmap on good governance for state institutions in the Republic of Macedonia - On the basis of the Regional Index of Openness of state institutions, gjendet në: https://resource.actionsee.org/app/uploads/2018/07/Action_SEE_MK_08-08-2017-english-version.pdf.
29 Danilovska D., Naumovska N. (2017). Propozime për përmirësimin e gjendjes momentale – Transparenca e institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon dhe në Maqedoni, Fondacioni Metamorfozis, gjendet në: https://resource.actionsee.org/app/uploads/2018/07/%D0%B7%D0%B0-%D0%BE%D1%82%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%B5%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D1%80%D1%88%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B2%D0%BB%D0%B0%D1%81%D1%822.pdf (qasje më 07.09.2019).

janë realizuar nga QRMV-ja, megjithatë, mungon një proaktivitet i këtillë tek organet të cilat mbajnë përgjegjësi para saj. Si rrjedhim, është më se e nevojshme të bëhen përpjekje plotësuese, në përputhje me detyrimet të cilat burojnë nga "Partneriteti për Qeverisje të Hapur" („Open Government Partnership"), si dhe në përputhje me Plan-veprimin nacional për partneritet të hapur qeveritar 2018-2020[30]

Përpjekjet e lartpërmendura janë sistematizuar në këtë dokument strategjik.

Njëri nga parimet themelore të Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021) është përdorimi i internetit si burim kryesor i informacioneve për punën e QRMV-së dhe të gjitha organeve dhe organizatave të përfshira me të. Kjo, është në përputhje me Ligjin për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik nga viti 2019, përkatësisht me nenin 10, paragrafin 1 të Ligjit, ku është specifikuar se çdo posedues i informacioneve e ka për detyrë që në ueb-faqen e tij të publikojë një numër të madh të dokumenteve dhe të dhënave.

QRMV në ueb-faqen e vet rregullisht publikon një numër të madh të të dhënave që janë të rëndësishme për punën e saj. Ato mund të gjenden në opsionin "Qeveri e hapur".[31] Aty janë përfshirë: (1) rendet e ditës dhe procesverbalet e mbledhjeve të QRMV-së; (2) të dhëna për pagat e anëtarëve të QRMV-së; (3) fletë deklarimet e anëtarëve të QRMV-së; (4) raportet për punën e QRMV-së (100 ditë, viti i 1 dhe viti i 2 nga formimi i përbërjes aktuale të QRMV-së); (4) buxheti i QRMV-së; (5) planet për prokurime publike; (6) raportet për realizimin e buxhetit; (7) raportet e auditit (deri në vitin 2012); (8) informacionet për shërbimet e QRMV-së; (9) të dhënat relevante për mbrojtjen e denoncuesve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me përcaktimet e ligjit në fjalë; (10) të dhënat për mënyrën e paraqitjes së kërkesës për qasje tek informacionet me karakter publik, ku bën pjesë edhe udhëzimi për aplikimin për qasje tek informacionet me karakter publik, formularë për aplikimin dhe të dhënat për personat zyrtarë për ndërmjetësim; (11) Rregullorja për organizimin e brendshëm të QRMV-së dhe Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në QRMV nga viti 2015, me 18 ndryshimet dhe plotësimet e saj përfundimisht me 15 korrik të vitit 2019; (12) organogrami i QRMV-së; (13) lista e të punësuarve në QRMV (duke e përfshirë Zyrën e kryetarit të QRMV-së dhe Sekretariatin e Përgjithshëm); (14) Strategjia e Komunikimit 2019/2020; (15) standardet grafike të QRMV-së dhe të ministrive; (16) Propozimi i Plan-veprimit të vendosur kundër përhapjes së dezinformatave; (17) tekstet relevante ligjore ku bën pjesë Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë (pa ndryshimet dhe plotësimit, i vitit 2018), Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore (pa ndryshimet dhe plotësimet nga vitit 2019) dhe Ligji për mbrojtjen e denoncuesve (teksti bazik); (18) aktet nënligjore me rëndësi për punën e QRMV; (19) Kodeksi për sjellje etike të anëtarëve të QRMV-së dhe të titullarëve të funksioneve publike të emëruar nga QRMV-ja, dhe (20) Plan-veprimi nacional për iniciativën Partneritet për Qeverisje të Hapur 2018-2020.

30 Gjendet në: http://www.mio.gov.mk/?q=mk/documents/open-government-partnership (qasje më: 08.09.2019).
31 Gjendet në: https://vlada.mk/otvorena-vlada (qasje më 06.09.2019).

Në mënyrë plotësuese, QRMV-ja e lançoi *Mekanizmin për llogaridhënie lidhur me shpenzimet e titullarëve të funksioneve publike*.[32] Ky mekanizëm mundëson këqyrje në shpenzimet zyrtare të Kryetarit të QRMV-së, dhe të zëvendëskryetarëve të QRMV-së, ministrave, zëvendësministrave, Sekretarit të Përgjithshëm të QRMV-së dhe të sekretarëve shtetërorë nëpër ministri. Mekanizmi përdoret me lehtësi, mundëson kërkim në bazë të më shumë kritereve (viti, organi, funksionari i organit, lloji i shpenzimit, ndërsa ka qasje edhe te raportet mujore për secilin nga funksionarët përkatës, përkatësisht shpjegime narrative për shpenzimet e theksuara). Si rrjedhim, ky mekanizëm e zmadhon në masë të konsiderueshme transparencën e QRMV-së dhe të ministrive, duke e pasur parasysh faktin se funksionarët janë të vetëdijshëm për kontrollin e publikut, përkatësisht këqyrjen në shpenzimet e tyre zyrtare.

Sa u përket prokurimeve publike, duhet të theksohet se të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë dhe ndërmarrjet publike e kanë për detyrë ta publikojnë dokumentacionin lidhur me prokurimet publike në Sistemin elektronik për prokurime publike[33] i cili është në kompetencë të Byrosë për Prokurime Publike. Si rrjedhim, në përputhje me nenin 10 paragrafin 1 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik nga viti 2019, ato e publikojnë konkursin/shpalljen, dokumentacionin e tenderit dhe kontratën për prokurimin publik.

U lancua platforma "Thesari i hapur" nëpërmjet së cilës të gjitha shpenzimet shtetërore bëhen publike, përkatësisht me automatizëm publikohen të gjitha transaksionet nga Thesari i Shtetit të cilat janë në dispozicion për monitorim. Me këtë preket njëra nga anomalitë kryesore, që ka të bëjë me nivelin e ulët të transparencës aktive kur bëhet fjalë për transparencën buxhetore dhe transparencën financiare.[34] Si rrjedhim, të dhënat të cilat publikohen nëpërmjet platformës "Thesari i hapur" janë informacione me karakter publik në përputhje me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/2019), përkatësisht në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e fundit të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik nga viti 2006. Rrjedhimisht me këtë, për lancimin e këtij mekanizmi nuk ishte e domosdoshme të fillohet me zbatimin e Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/2019).[35]

Çdo ministri, me përjashtim të ministrisë së themeluar para pak kohësh Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, posedon ueb-faqen e vet funksionale. Në këto ueb-faqe ka qasje edhe nëpërmjet ueb-faqes së QRMV-së, ku janë publikuar lidhjet (koneksionet) përkatëse.[36] Në ueb-faqet e ministrive mund të gjendet një numër i madh i të dhënave për punën e tyre, në përputhje me detyrimin për publikimin e 21 dokumenteve dhe të dhënave. Nga ana tjetër, sa u përket organeve në përbërje të ministrive, një pjesë më e

32 Gjendet në: https://vlada.mk/otchetnost-troshoci (qasje më 06.09.2019).
33 Gjendet në: https://e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/Home.aspx#/home (qasje më 06.09.2019).
34 Shih: http://ccc.org.mk/images/stories/ia2017m.pdf (qasje më 08.09.2019).
35 Gjendet në: https://open.finance.gov.mk/mk/home (qasje më 07.10.2019)
36 Shih: https://vlada.mk/ministerstva (qasje më 07.09.2019).

vogël e tyre posedojnë ueb-faqe, për një pjesë të tyre nëpër ueb-faqet e ministrive përkatëse janë publikuar vetëm të dhënat themelore, ndërsa për një numër më të vogël të organeve në internet vështirë gjenden të dhëna. Organet e pavarura të administratës shtetërore dhe organizatat administrative të specifikuara në pasqyrën numër 1 të kësaj Strategjie posedojnë ueb-faqe të tyre.

Për QRMV-në është jashtëzakonisht i rëndësishëm fakti që për herë të parë është publikuar "Buxheti qytetar", përkatësisht në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme mund të shihen detajet e buxhetit. Përveç ueb-faqes[37] u krijua edhe aplikacioni, që ishte njëri nga rekomandimet kryesorë të sektorit qytetar në të kaluarën.[38]

Në përputhje me Strategjinë për të Dhëna Transparente (2018-2020) u lancua Portali për të Dhëna Transparente të QRMV[39], qëllimi kryesor i të cilit është publikimi i dosarëve me të dhëna të institucioneve në format të hapur, me qëllim që të ketë transparencë më të madhe, shfrytëzimit të potencialit ekonomik të të dhënave dhe rritjes së efikasitetit të institucioneve. Midis të tjerash, në sfondin e Portalit për të dhëna transparente qëndron ideja për reduktimin e numrit të kërkesave për qasje tek informacionet me karakter publik, në atë mënyrë që vetë institucionet, në mënyrë proaktive, do t'i publikojnë informacionet. Njëkohësisht, Portali për të dhëna transparente duhet ta zmadhojë pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë krijimit të politikave dhe gjatë analizës së rezultateve të arritura. Karakteri interaktiv i Portalit për të dhëna transparente shihet nga fakti që çdo qytetar mund të regjistrohet aty dhe të bëjë vërejtje dhe komente, por edhe të parashtrojë kërkesa për publikimin e të dhënave të cilat deri në atë moment nuk janë publikuar. Në këtë mënyrë identifikohet roli aktiv i sektorit qytetar, përkatësisht i çdo qytetari, në kontrollimin e të dhënave të cilat i publikon QRMV-ja dhe organet e përfshira me këtë dokument strategjik.

37 Gjendet në: http://budget.finance.gov.mk/ (qasje më 07.09.2019).
38 Danilovska., Naumovska N. (2017). Propozime për përmirësimin e gjendjes momentale – Transparenca e institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon dhe Maqedoni, Fondacioni Metamorfozis, gjendet në: https://resource.actionsee.org/app/uploads/2018/07/%D0%B7%D0%B0-%D0%BE%D1%82%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%B5%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D1%80%D1%88%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B2%D0%BB%D0%B0%D1%81%D1%822.pdf (qasje më 07.09.2019).
39 Gjendet në: https://data.gov.mk/ (qasje më 07.09.2019).

### 4.1.1. Sfidat

QRMV-ja është e vetëdijshme se edhe përkrah numrit të madh të përpjekjeve për përmirësimin e transparencës gjatë punës, përkatësisht punës së ministrive, organeve në përbërje të ministrive, organeve të pavarura të administratës shtetërore, organeve administrative dhe organeve të pavarura shtetërore të cilat përgjigjen para saj, ekzistojnë rreziqe serioze lidhur me publikimin proaktiv të të dhënave në rrjetin e internetit. Në këtë kontekst, mund të theksohen hulumtimet e realizuara nga shoqatat e qytetarëve gjatë vitit 2017, kur niveli i përgjithshëm i transparencës aktive u vlerësua si i ulët, duke pasur parasysh se përqindja e përmbushjes së obligimeve për publikimin aktiv të informacioneve tek 97 institucionet e përfshira ishte 42,5%.40 Edhe pse nga viti 2017, deri në momentin e përpilimit të këtij dokumenti strategjik është shënuar progres i caktuar, megjithatë ekzistojnë edhe më tutje sfida. Në vazhdim, një pjesë e tyre prezantohen në kuadër të këtij dokumenti strategjik-planor.

Sfida e parë ka të bëjë me **mosunifikimin e ueb-faqeve të QRMV-së dhe të ministrive**. Me fjalë të tjera, analiza e realizuar, me qëllim që të hartohet Strategjia për transparencë të QRMV-së (2019-2021) rezultoi me konkluzionin se pothuajse secila prej tyre ka dizajn të ndryshëm, e që - vetvetiu - është sfidë për qytetarët, shoqatat e qytetarëve, për donacionet, mediat dhe për çdo subjekt tjetër të interesuar të gjejë të dhëna për punën e tyre. Nga ana tjetër, nuk ekziston standard në lidhje me atë se në cilat gjuhë do të jenë këto ueb-faqe.

Sfida e dytë ka të bëjë me **mosekzistimin e numrit të barabartë** të të dhënave nëpër ueb-faqet e të gjitha ministrive. Kjo gjë tanimë është konstatuar (edhe atë disa herë) nga shoqatat e qytetarëve, në hulumtimet e të cilave mund të vërehen dallime drastike në renditjen e ministrive nga aspekti i transparencës së tyre aktive.[41] Thënë me fjalë të tjera, përveç asaj që ueb-faqet e ministrive kanë dizajn dhe strukturë të ndryshme, vërehet edhe dallimi i të dhënave që janë postuar në to. QRMV-ja në mbledhjen e saj të 34 i ngarkoi të gjitha ministrisë të publikojnë minimum 21 dokumente në ueb-faqet e tyre.[42] Në mënyrë plotësuese, neni 10, paragrafi 1 i Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, i vitit 2019, i cili do të fillojë të zbatohet nga fundi i muajit nëntor të këtij viti, e zgjeron listën e dokumenteve dhe informacioneve kështu që i përfshin edhe poseduesit e tjerë të informacioneve përveç ministrive. Megjithatë, të gjitha ministritë nuk e kanë respektuar deri në fund udhëzimin e dhënë nga QRMV-ja.[43] Në vazhdim prezantohen disa shembuj:

40 Fikov G., Fakiq S., Mitevski M. (2017). Indeksi i transparencës aktive, Qendra për Komunikime Qytetare, gjendet në: http://ccc.org.mk/images/stories/ia2017m.pdf (qasje më 08.09.2019).
41 Fikov G., Fakiq S., Mitevski M. (2017). Indeksi i transparencës aktive, Qendra për Komunikime Qytetare, gjendet në: http://ccc.org.mk/images/stories/ia2017m.pdf (qasje më 08.09.2019).
42 Procesverbali gjendet në: https://vlada.mk/sednica/34 (qasje më 09.09.2019).
43 Për nivelin e ndryshëm të transparencës aktive të secilës ministri bëhet fjalë edhe në kuadër të hulumtimeve të realizuara me projektin Action SEE, gjendet në: https://opennessindex.actionsee.org/country/Macedonia (qasje më 09.09.2019).

- Në një pjesë të ueb-faqeve të ministrive nuk janë publikuar akoma listat e të gjithë të punësuarve me adresë zyrtare të postës elektronike dhe me telefon zyrtarë.[44]
- Në pjesën më të madhe të ueb-faqeve të ministrive, si dhe të organeve të tjera dhe organizatave të përfshira me këtë Strategji, nuk janë publikuar tekste të konsoliduara të ligjeve që janë të rëndësishëm për punën e tyre. Në një pjesë të këtyre ueb-faqeve është publikuar vetëm teksti origjinal i ligjit përkatës, pa iu bashkëngjitur ndryshimet dhe plotësimet, ndërsa disa nga ministritë e kanë publikuar tekstin origjinal me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet, por pa versionin e konsoliduar të ligjit. Një pjesë e ueb-faqeve kanë tekste të konsoliduara, megjithatë nuk janë përfshirë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet, por vetëm një pjesë e tyre (deri në vitin 2015 ose deri në vitin 2014).[45] Situata e njëjtë është edhe me aktet nënligjore të cilat janë të rëndësishme për punën e ministrive, përkatësisht të organeve dhe organizatave të tjera të përfshira me këtë Strategji.
- Disa nga ministritë kanë publikuar buxhete vjetore, megjithatë, nuk janë publikuar raportet e miratuara për realizimin e buxhetit.[46]

Sa i përket mosunifikimit të ministrive, nga aspekti i publikimit të të dhënave, flasin edhe hulumtimet e organizatave qytetare, veçanërisht nëpërmjet projektit Action-SEE, ku përcaktohet niveli i ndryshëm i transparencës për secilën ministri veç e veç.[47]

Ky mosunifikim i ministrive duhet të tejkalohet në prag të fillimit të zbatimit të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, i vitit 2019.

Sfida e tretë ka të bëjë me **organet në përbërje të ministrive**. Në tekstin më lart u specifikua se (edhe pse edhe ata janë posedues të informacioneve në përputhje me Ligjin për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, i vitit 2019) një pjesë e tyre nuk posedojnë fare ueb-faqe në të cilat do t'i publikonin të dhënat për punën e tyre. Në vazhdim prezantojmë disa organe të këtilla:

- Drejtoria për Siguri në Sistemin Hekurudhor (për të cilën të dhënat mund të gjenden vetëm në ueb-faqen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve).
- Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike (për të cilën të dhëna mund të gjenden vetëm në ueb-faqen e Ministrisë së Financave).
- Drejtoria Fitosanitare (për të cilën të dhëna mund të gjenden vetëm në ueb-faqen e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave).

44Për referencë shih: http://www.pravda.gov.mk/resursi/20 (qasje më 08.09.2019 ).
45 Për referencë shih: http://mtsp.gov.mk/zakoni.nspx (qasje më 08.09.2019 ), http://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20uslugi%20(3).pdf (qasje më 08.09.2019 ), http://zdravstvo.gov.mk/zakon-za-zdravstvenata-zashtita/ (qasje më 08.09.2019) dhe ngjashëm.
46 Për referencë shih: http://mtsp.gov.mk/informacii-od-javen-karakter.nspx (qasje më 08.09.2019).
47 Për referencë shih: https://opennessindex.actionsee.org/country/north-macedonia (qasje më 08.09.2019).

Kjo listë nuk është e apsolvuar dhe shërben për ilustrim.

Sfida e katërt ka të bëjë me **avancimin e Mekanizmit për llogaridhënie lidhur me shpenzimet e titullarëve të funksioneve publike.** Edhe pse ky mekanizëm është shembull pozitiv për rritjen e transparencës së QRMV-së dhe të ministrive, megjithatë duhet të merret parasysh se ai për momentin nuk i përfshin titullarët e funksioneve, as në organet në përbërje të ministrive, as në organet e pavarura të drejtorisë shtetërore, dhe as në organizatat administrative ose në organet e pavarura shtetërore të cilat përgjigjen para QRMV-së.

Sfida e pestë ka të bëjë me **bashkëpunëtorët e jashtëm** dhe me **këshilltarët personalë** të Kryetarit të QRMV-së. Ata angazhohen në bazë të Vendimit të kryetarit për themelimin e kabinetit të tij/saj. Duke e pasur parasysh se këta persona nuk janë angazhuar në përputhje me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, përkatësisht duke e pasur parasysh faktin që nuk ka kufizime lidhur me atë se sa këshilltarë të këtillë mund të angazhohen, nuk ekzistojnë ndalime për punësimin e familjarëve në këto vende pune ose nuk ekziston obligim që ata t'i ushtrojnë funksionet e tyre me orar të plotë të punës, kështu që nevojitet në ueb-faqen në mënyrë proaktive të publikohen të dhëna për të njëjtit, si vijon:

- emrat e tyre dhe beneficionet nga kontrata (dhe paga);
- në rastin kur bëhet fjalë për angazhim me orar të shkurtuar të punës ose për angazhim ad-hok të publikohen edhe të dhënat për punën / aktivitetin e tyre kryesor.

Përpjekjet e këtilla duhet të korrespondojnë me rekomandimet e GREKO-s të nënvizuara në Raportin e rrethit të pestë të vlerësimit.[48]

Sfida e gjashtë ka të bëjë me të **dhënat në lidhje me prokurimet publike**, përkatësisht është e domosdoshme të nënvizohet se pjesët e ueb-faqeve të QRMV-së, ministrive dhe organeve të tjera të përfshira me këtë dokument Strategjik duhet të lidhen me Sistemin elektronik për prokurime publike i cili është në kompetencë të Byrosë për Prokurime Publike, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje te të dhënat përkatëse nga cilado qoftë ueb-faqe. Gjatë lidhjes së këtillë duhet të mbahet llogari për shmangien e të dhënave të dyfishuara.

Sfida e shtatë ka të bëjë me **azhurnimin e rregullt të Protokollit për të dhëna të hapura të QRMV-së.** Në kuadër të kësaj analize të Portalit janë detektuar nëntë grupe të informacioneve (përmbledhje të dosarëve të të dhënave nga një fushë e caktuar), megjithatë, grupi i vetëm i cili është plotësuar emërtohet si "bujqësi, pylltari, peshkatari dhe ushqim". Si rrjedhim, është evidente se institucionet akoma e vlerësojnë si detyrim publikimin e të dhënave transparente, dhe jo si praktikë nga e cila edhe ata vetë do të kenë beneficione. Përkatësisht, nëse janë publikuar më shumë të dhëna, aq më e vogël do të jetë nevoja e qytetarëve të paraqesin kërkesa për qasje deri te informacionet me karakter publik.

48 Gjendet në: https://rm.coe.int/-/168095378e (qasje më 09.09.2019).

Sfida e tetë ka të bëjë me **nivelin e ulët të ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtën që të pranojnë, përkatësisht të kenë në dispozicion informacione për punën e QRMV-së dhe të të gjitha organeve e organizatave të cilat mbajnë përgjegjësi para saj**. Në hulumtimin e realizuar nga sektori qytetar[49] është ilustruar se nga numri reprezentativ i qytetarëve (mbi 1.200), pjesa më e madhe e tyre nuk kanë njohuri përkatëse për këtë të drejtë të tyre. Për shembull, çdo i anketuar i tretë mendon se "nuk ka të drejtë të kërkojë informacione nga institucionet shëndetësore dhe nga pushteti shtetëror". Përveç kësaj, një numër i madh i qytetarëve ka manifestuar skepticizëm lidhur me të drejtën e qasjes së lirë, përkatësisht madje një e katërta (28%) kanë deklaruar se nuk kërkojnë informacione me karakter publik, meqenëse janë të mendimit se nuk do t'u jepen; 16% nuk kanë kërkuar informacione meqenëse nuk kanë ditur ku të drejtohen; 7% kanë qenë të dekurajuar meqenëse nuk kanë pasur para, ndërsa 16% nuk kanë pasur kohë për një gjë të këtillë. Sa i përket nivelit të ulët të ndërgjegjësimit për të drejtën e kërkesës së informacioneve me karakter publik flasin edhe të dhënat e raporteve të KoQLI-së, sipas të cilave pothuajse pa përjashtim si ankimues në procedurat për qasje tek informacionet paraqiten shoqatat e qytetarëve. Niveli i ulët i ndërgjegjësimit për qasjen tek informacionet me karakter publik e bën evident faktin se qytetarët dinë akoma më pak për parimet e transparencës aktive, përkatësisht se ata duhet të kenë qasje te një numër i madh i të dhënave në ueb-faqet e organeve. Nga ana tjetër, sfidat e theksuara paraprakisht (heshtja e shpeshtë e administratës në procedurat për qasje tek informacionet, mosunifikimi i ueb-faqeve dhe ngjashëm) e vë në dukje faktin se tek organet dhe organizatat e përfshira me këtë Strategji niveli i ndërgjegjësimit nuk është i kënaqshëm.

Sfida e nëntë ka të bëjë me **mosekzistimin e njësisë organizative në QRMV, kompetente për monitorimin e ministrive dhe të organeve të tjera** lidhur me transparencën aktive. Me fjalë të tjera, edhe pse QRMV-ja në mbledhjen e saj të 34-të i ngarkoi të gjitha ministritë të publikojnë minimum 21 dokumente dhe të dhëna në ueb-faqet e tyre, megjithatë në kuadër të organizimit të saj të brendshëm nuk ekziston njësi e cila në mënyrë të rregullt do ta bënte monitorimin e ministrive dhe të organeve të tjera. Kjo është e domosdoshme, veçanërisht nëse merret parasysh se lista prej 21 dokumentesh dhe të dhënash është inkorporuar në nenin 10, paragrafin 1 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik.

49Danilovska-Bajdevska D., Petrovska M., Naumovska N. (red.). (2013). Tejkalimi i parimeve të fshehtësisë në punën e administratës – Raport nga hulumtimi i realizuar për të drejtën e qasjes së lirë deri te informacionet me karakter publik në Maqedoni, Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni, gjendet në: http://fosm.mk/CMS/Files/Documents/istrazuvanje-tajnnost-vo-rabotenjeto-mkd-1.pdf (qasje më 06.o9.2019).

### 4.1.2. Udhëzime strategjike

Nga sfidat e theksuara, QRMV-ja identifikoi dhe theksoi disa udhëzime strategjike:

- Unifikimi i llojit dhe numrit të dokumenteve, përkatësisht i të dhënave të cilat i publikon QRMV-ja dhe të gjitha organet dhe organizatat e tjera të përfshira me këtë dokument strategjik, duhet të arrihet në bazë të standardeve të krijuara paraprakisht në lidhje me atë se cilat dokumente dhe të dhëna do të publikohen, në mesin e të cilave, më së paku, do të përfshihen të dhënat si vijojnë:
    - të dhëna për organin, adresën e selisë së tij, kompetencat që i kryen, funksionarët në kuadër të organit dhe biografitë e tyre;
    - të dhëna themelore për kontakt me organin, ku bën pjesë numri i telefonit, numri i faksit, adresa e postës elektronike dhe adresa e ueb-faqes;
    - të dhëna themelore për kontakt me personin zyrtar për ndërmjetësimin e informacioneve, në përputhje me nenin 10, paragrafi 1 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik;
    - lista e personave të punësuar në organin, posta e tyre elektronike dhe telefoni;
    - lista e këshilltarëve të veçantë, përkatësisht e personave të angazhuar të cilët ofrojnë shërbime kontraktuese (nëse ekzistojnë), me ç'rast duhet të theksohet emri dhe mbiemri i tyre, profesioni i tyre, kohëzgjatja e angazhimit kontraktual dhe qëllimi i angazhimit, bashkë me të drejtat kontraktuale të cilat i kanë;
    - orari ditor i obligimeve të secilit nga funksionarët e përfshirë, i cili do të azhurnohet në bazë ditore;[50]
    - tekste të konsoliduara të ligjeve që kanë të bëjnë me kompetencën e organit ose organizatës;
    - tekste të konsoliduara të të gjitha rregulloreve (Rregullore për organizimin e brendshëm, Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës, Rregullore për denoncimin e mbrojtur të brendshëm etj.), urdhëresa, urdhra, udhëzime, plane, programe, aktvendime dhe lloje të tjera të akteve për zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera normative;
    - organogram për organizimin e brendshëm;
    - plane strategjike dhe strategji të cilat i implementon organi ose organizata;
    - plane dhe programe vjetore për punë;
    - buxheti vjetor dhe llogaria përfundimtare;
    - plane financiare vjetore sipas tremujorëve dhe programe për realizimin e buxhetit;

50Praktika e këtillë është vërejtur tek funksionarët më të lartë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për më shumë shih në: https://factba.se/ (qasje më 09.09.2019).

- plani vjetor për prokurime publike;
- raporte të auditit;
- lloje të shërbimeve që i jep organi ose organizata sipas përcaktimeve në nenin 10, paragrafin 1 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik;
- lista e tarifave për kompensimin e shërbimeve;
- mënyra se si mund të paraqitet kërkesë për qasje tek informacionet;
- dokumentacion i plotë për prokurime publike, identikë me atë që i dërgohet Byrosë për Prokurime Publike, me qëllim të publikimit në Sistemin elektronik për prokurime publike;
- projekt-programe, qëndrime, opinione, studime dhe dokumente të tjera që kanë të bëjnë me punën ose me aktet që janë në kompetencë të organit ose organizatës, si dhe komunikata për fillimin e procesit të hartimit të ndonjë akti të caktuar normativ;
- raporte pune të cilat i parashtron organi ose organizata dhe raporte pune të cilat i parashtrohen të njëjtit;
- të dhëna statistikore për punën, si dhe informacione të tjera për masat dhe aktivitetet me të cilat ndikohet mbi jetën e përditshme të qytetarëve;
- nëse bëhet fjalë për organ kolektiv – rendin e ditës të mbledhjeve dhe procesverbaleve nga të njëjtat;
- kërkesa anonime për qasje tek informacionet me karakter publikë, bashkë me përgjigjet që ia ka dërguar organi ose organizata, në mënyrë që të njëjtat të përdoren sërish edhe nga persona të tjerë krahas paraqitësit fillestar të kërkesës.

Standardet e hartuara duhet të inkorporohen në udhëzues (të cilin do ta hartojë QRMV-ja, në bashkëpunim me organizatat qytetare dhe kastën e ekspertëve), në mënyrë që organet dhe organizatat ta kuptojnë mirë obligimin që del nga neni 10, paragrafi 1 i Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik. Gjatë hartimit të standardeve, duhet të mbahet llogari për përcaktimin e obligimeve për azhurnimin e rregullt të të dhënave përkatëse, por edhe për unifikimin e formatit në të cilin do të publikohen ato (me qëllim që të shmangen dallimet të cilat ekzistojnë për momentin). Si rrjedhim, ueb-faqet duhet të unifikohen edhe sa i përket vizibilitetit, në masën që është e mundshme, në përputhje me standardet e theksuara, me ç'rast do të përmirësohet përvoja e shfrytëzuesve. Në këto standarde duhet të përfshihet edhe çështja se në cilat gjuhë do të jenë në dispozicion këto ueb-faqe, përkatësisht në ç'mënyrë të azhurnohen rregullisht të dhënat në secilin version të gjuhëve të ndryshme.

- Lidhja e të dhënave për prokurime publike, të postuara në ueb-faqet e ministrive dhe të organeve e organizatave të tjera të përfshira me këtë Strategji dhe të atyre në Sistemin elektronik për prokurime publike, kështu që të dhënat të korrespondojnë midis tyre.
- Avancimi i Mekanizmit për llogaridhënie lidhur me shpenzimet e titullarëve të funksioneve publike, duke ua bashkëngjitur funksionarët të cilët udhëheqin me organet në përbërje të ministrive, organet e pavarura të administratës shtetërore, organizatat administrative dhe organet e pavarura shtetërore të cilat përgjigjen para QRMV:
    - në rast të mos dërgimit të të dhënave, me qëllim të postimit të tyre në Mekanizmin për llogaridhënie lidhur me shpenzimet e titullarëve të funksioneve publike, personat përkatës mund të thërriten në përgjegjësi për shkak të shkeljes së detyrimit të përcaktuar në nenin 11, paragrafi 3 të Kodeksit për sjellje etike të anëtarëve të Qeverisë dhe titullarëve të funksioneve publike të emëruar nga Qeveria, në këtë rast, sa i përket monitorimit është ngarkuar ministri pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë.
- Avancimi dhe zhvillimi i Portalit për të dhëna transparente për QRMV-në, përkatësisht rritja e numrit të dosarëve me të dhëna të cilat do të jenë në dispozicion.
- Implementimi i fushatës publike për promovimin e unifikimit të ueb-faqeve të QRMV-së dhe të gjitha organeve dhe organizatave të përfshira me Strategjinë për transparencë të QRMV-së (2019-2021).
- Promovimi i të drejtës së qasjes tek informacionet dhe transparencës aktive të QRMV-së, nëpërmjet hartimit të broshurave, përgatitjes së fushatës mediatike dhe materialeve të tjera promovuese nga QRMV-ja, në bashkëpunim me Agjencinë, shoqatat e qytetarëve, fondacionet dhe mediat. Si aktivitet jashtëzakonisht i rëndësishëm gjatë fushatës publike do të paraqitet Mekanizmi për llogaridhënie lidhur me shpenzimet e titullarëve të funksioneve publike, e që nënkupton përpjekje të parë të kësaj natyre të QRMV-së. E drejta e qasjes tek informacionet dhe transparenca aktive do të promovohen edhe midis organeve dhe organizatave të përfshira me këtë Strategji, përkatësisht te funksionarët dhe personat zyrtarë brenda tyre, nëpërmjet përgatitjes së protokolleve dhe broshurave për të njëjtat.
- Formimi i njësisë organizative për zhvillim strategjik dhe transparencë në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së51, e cila do të ngarkohet t'i grumbullojë dhe analizojë të dhënat që kanë të bëjnë me implementimin e këtij dokumenti strategjik, përkatësisht me transparencën aktive në përgjithësi. Kjo njësi organizative duhet të ketë rol të trefishtë: (*) së pari, ajo do të grumbullojë të dhëna nga njësitë e tjera organizative në kuadër të QRMV-së, përkatësisht do ta monitorojë publikimin e të dhënave në ueb-faqen e saj, me qëllim të dhënies së rregullt të udhëzimeve

51 Organogrami gjendet në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/organogram_na_generalniot_sekretarijat.pdf (qasje më 08.09.2019).

nëse detektohen mangësi; (*) promovimi i transparencës, përkatësisht i të drejtës së qytetarëve të jenë të informuar për punën e QRMV-së dhe organeve të tjera të cilat përgjigjen para saj; (*) monitorimi i rregullt mbi të gjitha ministritë, organet në përbërje të ministrive, organet e pavarura të administratës shtetërore, organet e pavarura shtetërore, organizatat administrative, ndërmarrjet publike të themeluara nga QRMV-ja dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore, në aspekt të transparencës së tyre aktive, përkatësisht në aspektin e përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në mbledhjen numër 34-të të QRMV-së dhe në nenin 10, paragrafin 1 të Ligjit për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik. Kjo njësi organizative duhet të bashkëpunoj ngushtë me ministrin pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë. Përkatësisht, me qëllim të njoftimit me nivelin e implementimit të Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021), ajo në çdo tre muaj do t'i dërgojë raporte atij. Në mënyrë plotësuese, njësia organizative për zhvillim strategjik dhe transparencë do t'i adresojë edhe njoftime/raportime të veçanta ministrit përkatës për mosveprimin e cilitdo qoftë organi ose organizate në përputhje me detyrimet e parashikuara në mbledhjen numër 34-të të QRMV-së dhe në nenin 10, paragrafin 1 të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik. Pasi t'i pranojë raportimet e këtilla, ministri pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë do të ndërmarrë masa në përputhje me nenin 13 të Kodeksit për sjellje etike të anëtarëve të Qeverisë. Kjo njësi organizative dhe ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie, midis të tjerash, duhet të vendosin praktikë për komunikimin e rregullt me ndërmarrjet publike të themeluara nga QRMV-ja dhe me shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore, me qëllim që t'u vihet në dijeni se ato duhet të veprojnë në përputhje me këtë dokument Strategjik, përkatësisht me qëllim që të grumbullohen të dhëna në lidhje me atë nëse dhe në cilën mase të njëjtat janë komplementare.

Në Plan-veprimin i cili është pjesë përbërëse e Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021) janë parashikuar aktivitete konkrete për secilin udhëzim strategjikë, si dhe për indikatorët e monitorimit.

# 5. PËRGATITJA E AKTEVE NËNLIGJORE

## 5.1. Gjendja aktuale

Si një nga udhëzimet strategjike të këtij dokumenti strategjik-planor u theksua edhe publikimi i rregullt i të dhënave për fillimin e përgatitjes së akteve normative dhe akteve të tjera nënligjore në kompetencë të QRMV-së, ministrive, organeve në përbërje të ministrive, si dhe të gjitha organeve dhe organizatave të tjera të përfshira me të njëjtin.

Në momentin e hartimit të këtij dokumenti nuk ekziston Regjistri unik nacional për akte nënligjore, përkatësisht Regjistri unik nacional elektronik i akteve normative të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RUNE) i përmban vetëm propozim-ligjet.

### 5.1.1. Sfidat

Sfida e cila theksohet është **avancimi i RUNE-së me propozim-akte nënligjore** në mënyrë identike ashtu siç publikohen edhe propozim-ligjet. Si rrjedhim, organet dhe organizatat e përfshira me Strategjinë për Transparencë të QRMV-së (2019-2021) do t'i publikonin propozim-aktet nënligjore si në ueb-faqen e tyre ashtu edhe në ueb-faqen e RUNE-së.

### 5.1.2. Udhëzime strategjike

Në përputhje me sfidën e specifikuar, theksohet udhëzimi strategjik si vijon:

- Publikimi i propozim-akteve nënligjore jo vetëm në ueb-faqen e organit ose organizatës e cila e miraton por edhe në ueb-faqen e RUNE-së.

Pas miratimit të akteve nënligjore, në përputhje me përcaktimet strategjike të tekstit paraprak, duhet të publikohen në ueb-faqet e organeve dhe organizatave të cilat i kanë miratuar dhe puna e të cilave rregullohet me të njëjtat.

# 6. HARMONIZIMI ME DIREKTIVËN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR PËRDORIMIN E SËRISHËM TË INFORMACIONEVE ME KARAKTER PUBLIK

## 6.1. Gjendja aktuale

Në të drejtën e Bashkimit Evropian ekzistojnë disa burime sekondare të së drejtës në të cilat përfshihen dhe trajtohen aspekte të ndryshme të lirisë së informimit. Me miratimin e Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, i vitit 2019, Republika e Maqedonisë së Veriut në masë të madhe u harmonizua me standardet e përcaktuara nga Bashkimi Evropian. Në këtë drejtim, në mënyrë të veçantë do ta veçojmë Rregulloren nr. 1049/2001 dhe Direktivën 2003/4/KE. Megjithatë, në kuadrin e të drejtës së Bashkimit Evropian ekziston edhe Direktiva 2003/98/EC për përdorimin e sërishëm të informacioneve nga sektori publik. Fokusi i Direktivës për përdorimin e sërishëm të informacioneve nga sektori publik ka të bëjë me ripërdorimin e të gjitha dokumenteve që janë në dispozicion nëpërmjet trupave të sektorit publik, përveç se në rastet kur të njëjtat janë mbrojtur me të drejta autoriale. Në praktikë kjo nënkupton që pjesa më e madhe e të dhënave të ofrohen falas ose thuaja se falas, përveç rastit, nëse shpenzimet janë të arsyeshme; të arrihet sigurimi i detyrueshëm i të dhënave në formatin e përdorur më shpesh, dhe në formatin e lexueshëm me makinë, me qëllim që të dhënat të përdoren sërish dhe në mënyrë efektive, inkorporim të mbikëqyrjes rregullatore për zbatimin e parimeve; përhapje masive të shtrirjes së Direktivës, në mënyrë që për herë të parë të përfshihen edhe bibliotekat, muzetë dhe arkivat.[52]

### 6.1.1. Sfidat

Si sfidë që ka të bëjë me Direktivën 2003/98/EC theksohet **harmonizimi i legjislacionit nacional i Republikës së Maqedonisë së Veriut me këtë Direktivë.** Si rrjedhim, QRMV-ja identifikon se Ligji për shfrytëzimin e të dhënave me karakter publik ("Gazeta Zyrtare e

52 Bozhoviq S., Danilovska D. (2018). Raport preliminar për zbatimin e kornizës ligjore lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet me karakter publik, Fondacioni Metamorfozis, f. 9, gjendet në: http://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2018/04/1.5-Preliminaren-izveshtaj-sloboden-pristap.pdf (qasje më 09.09.2019).

Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014) është miratuar për këtë dedikim, megjithatë, zbatimi i tij është në nivel të palakmueshëm, ndërkaq mungojnë edhe analiza përkatëse të cilat do ta vënë në dukje faktin se në cilën masë e drejta e Bashkimit Evropian është transponuar në dispozitat e këtij ligji. Pikërisht për këtë arsye, në Strategjinë për të dhëna të hapura (2018-2020), në kuadër të masës së dytë të Strategjisë, ishte parashikuar shqyrtimi i këtij Ligji dhe përgatitja e rekomandimeve për ndryshime dhe plotësime eventuale të tij. QRMV-ja e identifikoi këtë masë strategjike edhe në kuadër të këtij dokumenti strategjik.

### 6.1.2. Udhëzime strategjike

Në përputhje me atë që u tha paraprakisht, QRMV-ja si udhëzim strategjik e përsërit atë që është theksuar në Strategjinë për të dhëna të hapura (2018-2020):

- Realizimi i analizës për Ligjin ekzistues për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik dhe për aktet nënligjore të miratuara në bazë të të njëjtit dhe nëse është e nevojshme, të propozohen ndryshime në legjislacion, me qëllim që të harmonizohet me Direktivën e Bashkimit Evropian për përdorimin e sërishëm të informacioneve të sektorit publik 2003/98/EC.

# Pjesa 3:

## Anekse të Strategjisë për transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2019-2021)

# **Aneksi 1:**
## Pasqyra e një pjese të organeve që janë përfshirë me Strategjinë për transparencë të QRMV-së (2019-2021)

*Pasqyra – Pjesë e organeve dhe organizatave të përfshira me Strategjinë për transparencë të QVRM-së (2019-2021)*

**Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

| Organe të pavarura të administratës shtetërore |
|---|
| Agjencia për të Rinj dhe Sport |
| Agjencia për Emigracion |
| Agjencia për Ushqim dhe Veterinari |
| Komisioni për Marrëdhënie me Komunitetet Fetare dhe Grupet Religjioze |
| Agjencia për Siguri Nacionale |

| Organizata administrative |
|---|
| Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| Enti Shtetëror i Statistikave |

| Ministritë | Organe në përbërje |
|---|---|
| Ministria e Punëve të Brendshme | Byroja për Siguri Publike |
| Ministria e Punëve të Jashtme | / |
| Ministria e Mbrojtjes | / |
| Ministria e Drejtësisë | Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve<br>Byroja për Ekspertiza Gjyqësore<br>Drejtoria për Administrimin e Librave të Amzës<br>Byroja për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut |
| Ministria e Punës dhe Politikës Sociale | Drejtoria për Çështjet e Luftëtarëve dhe Invalidëve të Luftës<br>Inspektorati Shtetëror i Punës |

| Ministritë | Organe në përbërje |
|---|---|
| Ministria e Arsimit dhe Shkencës | Shërbimi Pedagogjik |
| | Byroja për Zhvillimin e Arsimit |
| | Inspektorati Shtetëror i Arsimit |
| Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës | Inspektorati Shtetëror Administrativ |
| Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave | Drejtoria për Ekonominë e Ujërave |
| | Drejtoria Fitosanitare |
| | Laboratori Shtetëror Fitosanitar |
| | Drejtoria për Farëra dhe Material Mbëltimi |
| | Inspektorati Shtetëror për Bujqësi |
| | Inspektorati Shtetëror për Pylltari dhe Gjueti |
| Ministria e Financave | Drejtoria e Doganave |
| | Drejtoria e të Ardhurave Publike |
| | Drejtoria e Policisë Financiare |
| | Drejtoria e Zbulimit Financiar |
| | Byroja për Prokurime Publike |
| | Drejtoria për Çështje Pronësore – Juridike |
| | Inspektorati Shtetëror për Deviza |
| Ministria e Vetëqeverisjes Lokale | nspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale |
| | Byroja për Zhvillim Rajonal |
| Ministria e Kulturës | Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore |

| Ministritë | Organe në përbërje |
|---|---|
| Ministria e Transportit dhe Lidhjeve | Kapitaneria e Porteve<br>Inspektorati Shtetëror për Transport<br>Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm<br>Inspektorati Shtetëror Komunal<br>Drejtoria për Siguri në Sistemin Hekurudhor |
| Ministria e Shëndetësisë | Inspektorati Sanitar dhe Shëndetësor Shtetëror<br>Drejtoria për Shëndetësi Elektronike |
| Ministria e Ekonomisë | Byroja e Metrologjisë<br>Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik<br>Inspektorati Shtetëror i Tregut<br>Drejtoria e Prodhimit me Dedikim |
| Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor | Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor<br>Drejtoria e Mjedisit Jetësor |
| Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive | Drejtoria për Afirmimin dhe Avancimin e Kulturës së Pjesëtarëve të Bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut<br>Drejtoria për Zhvillimin dhe Avancimin e Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Bashkësive |



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

↓

| Ndërmarrje publike themelues i të cilave është Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore |
|---|
| SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut |
| SHA Posta e Maqedonisë |
| Hekurudhat e Maqedonisë Transport SHA-Shkup |
| SHA OSTEM Shkup (Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Maqedoni) |
| SHA Lotaria e Shtetit |
| SHA Ekonomia e Ujërave të Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| SHA për Ndërtim dhe Ekonomizim me Hapësira Banimi dhe Afariste të Rëndësishme për Republikën |
| NP për Ekonomizim me Pyjet Shtetërore - Pyjet e Maqedonisë |
| NP për Rrugë Shtetërore |
| NP Rrugët e Maqedonisë |
| NP për Infrastrukturë Hekurudhore - Hekurudhat e Maqedonisë |
| NP Radiodifuzioni i Maqedonisë |
| NP Strezhevë - Manastir |

# **Aneksi 2:**
Plan-veprimi i Strategjisë për transparencë të QRMV-së (2019-2021)

| Kapitulli | Udhëzimi strategjik | Masa/Masat | Aktiviteti/ Aktivitetet | Trupi kompetent | Afati i veprimit | Indikatori/Indikatorët i/e suksesit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qasja tek informacionet | Avancimi i praktikës së organeve qeveritare në implementimin e parimit për delegimin e kompetencës, në përputhje me LPPA, në procedurat për qasje tek informacionet. | 1. Sugjerime individuale për secilin person përgjegjës të organit i cili përgjigjet para QRMV-së për realizimin e detyrueshëm të konkluzionit nga mbledhja e rregullt nr. 120 sipas të cilës vendimet për qasje tek informacionet do t'i miratojnë dhe nënshkruajnë personat zyrtarë të organit.<br><br>2. Fuqizimi i ndërgjegjësimit të QRMV-së dhe të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar nga Qeveria lidhur me rëndësinë e parimit të delegimit të kompetencës në procedurat për qasje tek informacionet, si masë themelore për shmangien e ndikimit politik gjatë realizimit të transparencës. | 11.1. Përpilimi i modelit të aktvendimit për mbartjen e autorizimit për vendimmarrje në procedurat për qasje tek informacionet.<br><br>1.2. Mbartja e autorizimit, nga personi përgjegjës te personi zyrtar, për qasje të lirë tek informacionet për vendimmarrje të pavarur në procedurat për qasje tek informacionet.<br>2.1. Përpilimi i udhëzuesve dhe materialit tjetër informativ për zbatimin konsekuent të parimit të delegimit dhe respektimit të afateve për vendimmarrje. | 1.1 - 1.2. Ministri i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë, Sekretariati i Përgjithshëm i QRMV-së dhe ASPI-t<br><br>2.1. ASPI | 1.1. janar 2020.<br>1.2. shkurt 2020. | - Modeli i aktvendimit për mbartjen e autorizimit për vendimmarrje në procedurat për qasje, u është dërguar të gjitha organeve qeveritare dhe çdo organizate që është përfshirë me këtë Strategji.<br><br>- Udhëzuesit dhe materiali tjetër informativ u janë dërguar të gjitha organeve qeveritare dhe çdo organizate që është përfshirë me këtë Strategji.<br><br>- ASPI ofron dhe jep këshilla në procesin e avancimit të praktikës së organeve qeveritare në implementimin e parimit të delegimit të kompetencës në përputhje me LPPA-në. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qasje tek informacione** | Vendosja e marrëdhënies së partneritetit ndërmjet QRMV dhe Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtës së Qasjes së Lirë deri te Informacionet me Karakter Publik.. | 1. Informimi i rregullt i QRMV-së nga ASPI, në lidhje me shkallën e implementimit të LQLIKP-së: (*) të dhëna statistikore në nivel vjetor; (*) numri i vendimeve të ankimuara; (*) numri i ankesave të aprovuara; (*) ekzekutimi i vendimeve të ASPI-t; (*) raporte periodike në lidhje me paligjshmëri më të mëdha të detektuara në punën e organeve të caktuara.<br><br>2. Caktimi i personit zyrtar në ASPI, përgjegjës për komunikimin e vazhdueshëm, për bashkëpunim, analizë dhe shkëmbim të informacioneve dhe të dhënave për situatat në lidhje me personin zyrtar nga njësia e re organizative pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së<br><br>3. Analiza dhe implementim i rekomandimeve të Kuvendit të RMV-së nga Raporti i miratuar vjetor i ASPI-t. | 1.1. U miratua akt për sistematizimin e Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së, me realizues të parashikuar nga njësia e re organizative me detyrë pune t'i analizojë të gjitha të dhënat dhe informacionet e pranuara nga ASPI.<br>1.2. Zgjedhja (nëpërmjet konkursit publik, konkursit të brendshëm ose nëpërmjet mobilitetit) të nëpunësit administrativ me detyrë pune analizim të të gjitha të dhënave dhe informacioneve të pranuara nga ASPI.<br><br>2.1. U miratua akti për sistematizimin e Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së me realizues të parashikuar nga njësia e re organizative, i cili do të ketë detyrë pune të komunikojë me ASPI.<br>2.2. Zgjedhja (nëpërmjet konkursit publik, konkursit të brendshëm ose nëpërmjet mobilitetit) e nëpunësit administrativ me detyrë pune komunikim i rregullt me ASPI<br><br>3.1. Përgatitja e propozim-konkluzioneve të QRMV-së nga ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie në lidhje me rekomandimet e Kuvendit të RMV-së. | 1.1. Sekretariati i Përgjithshëm i QRMV-së, MSHIA, dhe MF-ja.<br>1.2. Sekretariati i Përgjithshëm, ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie.<br>2.1. Sekretariati i Përgjithshëm i QRMV-së, MSHIA, dhe MF-ja.<br><br>2.2. Sekretariati i Përgjithshëm, ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie.<br>3.1. Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie. | 1.1. dhjetor 2019.<br>1.2. janar 2020.<br>.<br><br>2.1. dhjetor 2019.<br>2.2. janar 2020.<br>3.1. Еден 3.1. Një muaj pas miratimit të Raportit për punën e ASPI-t nga Kuvendi i RMV-së. . | - Memorandum bashkëpunimi ndërmjet QRMV-së dhe ASPI-t.<br><br>- U miratua akt për sistematizimin e Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së me realizues të parashikuar nga njësia e re organizative, me detyrë pune analizim i të gjitha të dhënave të pranuara nga ASPI dhe plotësimi i suksesshëm i këtij vendi të punës..<br><br>- U publikuan të dhënat për implementimin e rekomandimeve të Kuvendit të RMV-së pas miratimit të Raportit vjetor të ASPI-t në ueb-faqen e QRMV-së dhe nëpërmjet kanaleve të tjera.<br><br>- U publikuan të dhëna për masat e ndërmarra nga QRMV-ja ndaj organeve qeveritare sipas sugjerimeve të ASPI-t se organet qeveritare nuk e respektojnë kornizën ligjore. |



| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Transparenca aktive** | Numër minimal i informacioneve dhe dokumenteve me obligim të publikohen në ueb-faqen e çdo organi, të azhurnohen rregullisht, por edhe të ruhen dokumentet dhe informacionet e vjetra. | 1. Përpilimi i listës me numër minimal të informacioneve dhe dokumenteve me obligim të publikohen në ueb-faqen e çdo organi. | 1.1. Përpilimi i listës.<br>1.2. Dërgimi i listës deri te organet | 1.1. Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie<br>1.2. Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie. | 1.1. janar 2020.<br>1.2. janar 2020. | - ekzistimi i listës/katalogut publik me dokumente të cilat duhet të jenë me doemos në dispozicion për publikun.<br><br>- Lista/katalogu publik i dokumenteve u është dërguar të gjitha organeve dhe organizatave të përfshira me këtë Strategji.<br><br>- U publikua e dhëna në ueb-faqen e QRMV-së mbi numrin e organeve të cilat e respektojnë obligimin që të publikojnë dokumente relevante në ueb-faqet e tyre.<br><br>- Njësia organizative e sapoformuar për zhvillim strategjik dhe transparencë monitoron rregullisht nëse dhe në cilën masë organet qeveritare i publikojnë të dhënat dhe dokumentet. |
| **Transparenca aktive** | Lidhja e të dhënave për prokurime publike të postuara në ueb-faqet e ministrive dhe organeve e organizatave të tjera të përfshira me këtë Strategji dhe atyre të Sistemit elektronik për prokurime publike. | 1. Lidhja e të dhënave të organeve dhe organizatave të përfshira me këtë Strategji dhe atyre të Sistemit elektronik për prokurime publike. | 1.1. Të gjitha bazat ekzistuese të të dhënave dhe portaleve të organeve qeveritare janë lidhur me Sistemin elektronik për prokurime publike, kështu që të dhënat do të përputhen. коинцидираат. | 1.1. Shërbimi – TI pranë Zyrës së KQRMV-së. | 1.1. shtator 2020. | - Të dhënat për prokurimet publike në ueb-faqet e organeve qeveritare, korrespondojnë me ato të Sistemit elektronik për prokurime publike.<br><br>- Njësia organizative e sapoformuar për zhvillim strategjik dhe transparencë monitoron rregullisht se a ka devijime. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Transparenca aktive** | Avancim të Mekanizmit për llogaridhënie lidhur me shpenzimet e titullarëve të funksioneve publike. | 1. Konkluzioni i QRMV-së për zgjerimin e Mekanizmit për llogaridhënie lidhur me shpenzimet e titullarëve të funksioneve publike. | 1.1. Përpilimi i listës së zgjeruar të funksionarëve.<br><br>1.2. Përpilimi i metodologjisë për monitorimin e realizimit të konkluzionit.<br><br>1.3. U miratua akt për sistematizimin e Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së me realizues të parashikuar nga njësia e re organizative i cili do të ketë detyrë pune ta monitorojë implementimin e konkluzionit nga masa nr. 1.<br><br>1.4. Zgjedhja (nëpërmjet konkursit publik, konkursit të brendshëm ose nëpërmjet mobilitetit) e nëpunësit administrativ me detyrë pune siç është parashikuar në aktivitetin 1.3 | 1.1. Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie.<br><br>1.2. Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie.<br><br>1.3. Sekretariati i Përgjithshëm, Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie.<br><br>1.4. Sekretariati i Përgjithshëm, Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie. | 1.1. qershor 2020.<br><br>1.2. qershor 2020.<br><br>1.3. dhjetor 2019.<br><br>1.4. janar 2020. | - U përpilua listë e zgjeruar e funksionarëve.<br><br>- U përpilua metodologjia e monitorimit të realizimit të konkluzionit.<br><br>- U miratua akt i ri për sistematizimin e Sekretariatit të Përgjithshëm me realizues të parashikuar, me detyrë pune monitorim i implementimit e konkluzionit për zgjerimin e Mekanizmit për llogaridhënie lidhur me shpenzimet e titullarëve të funksioneve publike.<br><br>- Informimi i rregullt i ministrit të ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë në lidhje me mos dërgimin informacioneve nga titullarët e funksioneve publike dhe procedimi në përputhje me Kodeksin për sjellje etike të anëtarëve të Qeverisë dhe titullarëve të funksioneve të emëruar nga Qeveria. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Transparenca aktive** | Realizimi i fushatës publike për promovimin e ueb-faqeve të unifikuara. | 1. Informacione për publikun në lidhje me përmbajtjen dhe mënyrën e përdorimit të ueb-faqeve të organeve, të transmetuara nëpërmjet mediave, nëpërmjet diskutimeve dhe debateve publike dhe nëpërmjet rrjeteve sociale, si dhe promovimi në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë dhe ngjashëm.<br>2. Trajnim të personave zyrtarë në organet kompetente për mirëmbajtjen e ueb-faqeve | 1.1. Përcaktimi i përmbajtjes së materialit informativ nga masa nr. 1<br><br>2.1. Hartimi i materialeve për trajnim.<br><br>2.2. Përcaktimi i numrit të dëgjuesve, përcaktimi i orarit të trajnimit.<br><br>2.3. Përcaktimi i trajnuesve.<br><br>2.4. Realizimi i trajnimeve. | 1.1. Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie.<br><br>2.1. - 2.4. Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie dhe njësia e re organizative | 1.1. janar 2020<br><br>2.1. mars-shtator 2020.<br><br>2.2. mars-shtator 2020.<br><br>2.3. mars-shtator 2020.<br><br>2.4. mars-dhjetor 2020. | - Përmbajtje të cilat kanë për synim ta informojnë publikun për të drejtën e tij që të jetë i informuar mbi punën e Qeverisë të krijuara në mënyrë të lehtë dhe të qasshme (video, broshura dhe ngjashëm)<br><br>-Ekzistimi i rubrikës "Pyetje të parashtruara më shpesh" në ueb-faqen e QRMV-së;<br><br>- Qasja në informacionet kthyese nga organet e rubrikës "Pyetje të parashtruara më shpesh".<br><br>- Ueb-faqet e QRMV-së dhe e organeve qeveritare posedojnë rubrikë për vlerësimin e transparencës së tyre ku qytetarët mund ta shprehin shkallën e kënaqësisë së tyre.<br><br>- U hartua programi për promovim në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë dhe ngjashëm.<br><br>- U hartua programi për trajnimin e personave zyrtarë në organet kompetente për mirëmbajtjen e ueb-faqeve. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Transparenca aktive** | Promovimi i të drejtës për qasje të lirë tek informacionet dhe transparencës aktive. | 1. Informacione për publikun për të drejtën e tij që të jetë i informuar mbi punën dhe aktivitetet e çdo organi i cili mban përgjegjësi para Qeverisë, nëpërmjet mediave, rrjeteve sociale dhe debateve publike, me komunikata për publikun, me broshura me fotografi që kuptohen lehtë dhe ngjashëm, si dhe nëpërmjet promovimit në kuadër të shkollave të mesme dhe institucioneve të arsimit të lartë. | 1.1. Përcaktimi i përmbajtjes së materialit informativ nga masa nr. 1.<br><br>1.2. Përgatitja e video-materialeve dhe broshurave.<br><br>1.3. Përpilimi i "Pyetje të pashtruara më shpesh" nga qytetarët dhe përgjigjet ndaj tyre në ueb-faqen e QRMV-së.<br><br>1.4. Ligjërata në shkollat e mesme dhe universitete.<br><br>1.5. Hartimi i analizës për LQLIKP.<br><br>1.6. Implementimi i fushatave dhe llojeve tjera të promovimeve. | Ministri i ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie, ASPI, organizata joqeveritare. | 1.6. qershor 2020.<br>.<br>1.6. Në vazhdimësi | - Përmbajtje të cilat synojnë ta informojnë publikun për të drejtën e tij që të jetë i informuar mbi punën e Qeverisë të krijuara në mënyrë të lehtë dhe të qasshme (video, broshura dhe ngjashëm)<br><br>- Ekzistimi i rubrikës "Pyetje të parashtruara më shpesh" në ueb-faqen e QRMV-së;<br><br>- Qasje në informacionet kthyese nga organet e rubrikës "Pyetje të parashtruara më shpesh".<br><br>- Ueb-faqet e QRMV-së dhe e organeve qeveritare posedojnë rubrikë për vlerësimin e transparencës së tyre ku qytetarët mund ta shprehin shkallën e kënaqësisë së tyre.<br><br>- U hartua programi për promovim në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë dhe ngjashëm.<br><br>- U hartua programi për trajnimin e personave zyrtarë për ndërmjetësim me informacione.<br><br>- Analiza e Ligjit të ri, LQLIKP, e publikuar në formë elektronike në ueb-faqen e QRMV-së. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Transparenca aktive** | Formimi i njësisë organizative për zhvillim strategjik dhe transparencë, në kuadër të SP-së së QRMV-së e cila do të ngarkohet për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave që kanë të bëjnë me implementimin e kësaj Strategjie. | 1. Fillimi me punë i njësisë së re organizative. | 1.1. Ngarkimi i Sektorit për Resurse Njerëzore dhe Çështje Kadrovike të hartojë rregullore të reja.<br>1.2. Marrja e pëlqimit nga organet kompetente.<br>1.3. Miratimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në SP pranë QRMV-së.<br>1.4. Punësimi i realizuesve në njësinë e re organizative nëpërmjet konkursit publik/ konkursit të brendshëm / mobilitetit. | 1.1. SP-ja e QRMV-së<br><br>1.2. MSHIA.<br><br>1.3. SP-ja e QRMV-së<br><br>1.4. SP-ja e QRMV-së dhe MF-ja. | 1.1. nëntor 2019.<br><br>1.2. dhjetor 2019.<br><br>1.3. dhjetor 2019.<br><br>1.4. janar/ shkurt 2020. | - Njësia organizative e sapoformuar ka realizues të punësuar (të përzgjedhur nëpërmjet konkursit publik / konkursit të brendshëm / mobilitetit). |
| **Akte nënligjore** | Publikimi i propozim-akteve nënligjore në RUNE. | 1. Vendimi i QRMV për ngarkimin e të gjitha organeve të cilat mbajnë përgjegjësi para QRMV t'i publikojnë propozim-aktet nënligjore.<br><br>2. Modifikim sistemor i Regjistrit unik nacional i akteve normative për postimin e propozim-akteve nënligjore. | 1.1. Përpilimi i vendimit nga masa numër 1, me udhëzime konkrete dhe afate kohore për organet.<br><br>1.2. Miratimi i vendimit nga aktiviteti nr. 1.1.<br><br>2.1. Krijimi i zgjidhjes softuerike.<br><br>2.2. Postimi i propozim - akteve nënligjore nga ana e organeve. | 1.1. MSHIA.<br><br>1.2. QRMV.<br>2.1. Shërbimi TI (QRMV, MSHIA).<br>.<br>2.2. Të gjitha organet. | 1.1. janar 2020.<br>1.2. shkurt 2020..<br><br>2.1. shkurt-qershor 2020.<br>2.2. qershor 2020- në vazhdimësi. | - Në rubrikën "akte normative" të RUNE-së ekziston mundësia që shfrytëzuesi të përzgjedhë se a dëshiron të kërkojë ligje ose akte nënligjore.<br><br>- Njësia organizative e sapoformuar për planifikim strategjik dhe transparencë, monitoron rregullisht nëse dhe në cilën masë publikohen aktet nënligjore nga organet dhe në rast të devijimit, inicion procedura në përputhje me Kodeksin etik para ministrit të ngarkuar për komunikime, transparencë dhe llogaridhënie. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Harmonizimi me të drejtën e BE** | Realizimi i analizës për Ligjin ekzistues për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik dhe të akteve nënligjore dhe propozimi (eventual) i ndryshimeve me qëllim që të arrihet harmonizimi me Direktivën e BE-së për përdorimin e sërishëm të informacioneve nga sektori publik. | 1. Analizë e përpiluar për Ligjin ekzistues për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik dhe të akteve nënligjore, me qëllim që të harmonizohen me Direktivën e BE-së për përdorimin e sërishëm të informacioneve nga sektori publik.<br><br>2. Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik. | 1.1 Formimi i Grupit të Punës pranë MSHIA-së.<br>1.2. Dërgimi i rezultateve të analizës te QRMV-ja.<br><br>22.1. Formimi i Grupit të Punës pranë MSHIA-së.<br>2.2. Përpilim i draft-ndryshimeve dhe plotësimeve për QRMV-në.<br>2.3. Publikimi në RUNE.<br>2.4. Procedurë në QRMV për miratimin e propozim-ndryshimeve dhe plotësimeve.<br>2.5. Miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve nga Kuvendi. | QRMV, MSHIA, SÇE, sektori joqeveritar. | 1.1. janar 2020<br>1.2. shkurt 2020<br><br>2.1. shkurt 2020.<br>2.2. shkurt/mars 2020.<br><br>2.3. mars 2020.<br>2.4. prill 2020.<br><br>2.5. prill/maj 2020. | - U formua Grupi i Punës në kuadër të Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.<br><br>- Rezultate nga analiza e Ligjit për përdorimin e informacioneve nga sektori publik të dërguara te QRMV-ja.<br><br>- U përcaktua procedura në QRMV për miratimin e draft-amendamenteve, e njëjta është e qartë dhe u aprovua nga palët relevante të interesuara.<br><br>Amendamentet u aprovuan nga Kuvendi. |

# Indeksi i akronimeve në Planin e Veprimit:

- ASPI – Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik;
- QRMV – Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- MSHIA – Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës;
- MF – Ministria e Financave;
- TI – Teknologjia e Informacionit;
- KQRMV – Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- SP pranë QRMV-së – Sekretariati i Përgjithshëm pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- SÇE – Sekretariati për Çështje Evropiane;..